



Buletini i Shkencave Gjeologjike
1/2025
Buletin of Geological Sciences

BORDI EDITORIAL

DR. MADALINA - ELENA KALLANXHI - KRYEREDAKTOR

DR. SIRELDA BELE - SEKRETAR

DR. ENTON BEDINI- ANËTAR

PROF. DR. IBRAHIM MILUSHI - ANËTAR

PROF. AS. EDMOND DUSHI - ANËTAR

DR. ARJOL LULE - ANËTAR

DR. BESNIK AGO - ANËTAR

INXH. HENRI NIKOLLA - REDAKTOR TEKNIK

ISSN 0254-5276

Ndikimi i ndryshimeve klimatike në dinamikën e proceseve hidrokimike të ujërave nëntokësore në rajonin Ohër - Prespë, Shqipëria juglindore

[The impact of climate change on the dynamics of hydrochemical processes of groundwater in the Ohrid – Prespa region, southeastern Albania]

Brisilda Stafa, Arjan Beqiraj 7 [23]

Ndikimi në mjedis i mbetjeve të aktivitetit minerar në zonën e Rehovës (Qarku i Korçës)

[Environmental impact of mining activity waste in the Rehova area (Korça district)]

Ina Gjonaj, Adrian Bylyku, Petrit Picaku, Shefki Hysa, Julinda Sulejmani, Maga Ceroni 39 [57]

Disa të dhëna mbi thyerjet e vjetra të riftëzimit në Njësinë e Lisen - Spitenit

[Some data on the rift faults in the Lisen – Spiten Unit]

Dhurata Ndreko, Arjol Lule, Shaqir Nazaj 75 [83]

Biostratigrafia e nanofosileve gëlqerore nga Formacioni “Mergelet me *Chama*” në Moravë Shqipëri (Baseni Shqiptaro – Thessalian)

[Calcareous nannofossils’ biostratigraphy from “Marls with *Chama*” Formation in Morava Albania (Albanian – Thessalian Basin)]

Mădălina – Elena Kallanxhi 91 [105]

Të dhëna gjeologjike mbi mënyrën e formimit të trupave kromitike dhe shkëmbinjëve rrethues në masivin e Shebenikut

[Geological data on the formation of chromite bodies and the surrounding rocks in the Shebenik Massif]

Dashamir Gega 119 [131]

NDIKIMI I NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË DINAMIKËN E PROCESIVE HIDROKIMIKE TË UJËRAVE NËNTOKËSORE NË RAJONIN OHËR - PRESPË, SHQIPËRIA JUGLINDORE

BRISILDA STAF¹ & ARJAN BEQIRAJ^{2*}

¹Instituti i Gjeoshkencave, UPT, Rruga: Don Bosko, No.60, Tiranë, Shqipëri

²Universitetit Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave,
Bulevardi Dëshmorët e Kombit Nr. 4, Tiranë, Albania.

*Autor korrespondent: arjan.beqiraj@fgjm.edu.al

(Dorëshkrim i dorëzuar në gusht 2025; i pranuar për botim në nëntor 2025)

Abstrakt. Ky artikull synon vlerësimin e pasojave të ndryshimeve klimatike në proceset hidrokimike dhe regjimin e ujërave nëntokësore të ekosistemit ujor Ohër – Prespë nëpërmjet studimit të veçorive fiziko-kimike të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Vargmali Mali i Thatë – Galiçicë, i ndërtuar nga gëlqërore triasiko-jurasike, përmban ne vetvete forma karstike që mundesojnë lëvizjen e ujërave nëntokësore drejt liqenit Ohër dhe daljen e tyre në trajtë burimesh. Veçoritë hidrokimike i klasifikojnë ujërat ekosistemit Ohër-Prespë në tipin Ca-HCO_3 dhe Ca-Mg-HCO_3 , me burim më të fortë përkatësisht nga karsti dhe liqeni Prespa e Madhe. Ujërat e tipit Ca-HCO_3 dallohen për vlera më të ulëta të Minëralizimit të Përgjithshëm ($\text{MP} < 300\text{mg/l}$), ndërsa ujërat e tipit Ca-Mg-HCO_3 dallohen për vlera më të larta të Minëralizimit të Përgjithshëm ($\text{MP} > 300\text{mg/l}$). Vlerësimi sasi i kontributit të karstit dhe liqenit Prespa e Madhe në ujin e burimeve që dalin në bregun e liqenit Ohër, e kryer përmes ekuacionit të bilancit të masës të fraksioneve ujore të përziera dhe bilancit kimik të përmbajtjes së klorureve në ujë, tregoi që, në stinen e pranverës, burimet Elshan, Kufi dhe Biljana ushqehen në masën mbi 50% nga uji i karstit, ndërsa në atë të vjeshtës, edhe burimet Tushemisht, Gurras dhe Shën Naum ushqehen në mbi 50% nga karsti. Kjo gjetje, që konfirmohet nga ulja e ndjeshme e silicës në ujin e burimeve të kampionuar në vjeshtë, tregon që me rënien e nivelit të ujit në liqenin Prespa e Madhe, pesha specifike në ushqimin e burimeve dhe të vetë liqenit Ohër i kalon karstit.

Fjalë kyçe: Burime karstike, ujëra nëntokësore, ndryshime klimatike, Liqeni Prespa e Madhe, Ohër.

HYRJA

Ujërat nëntokësore përbëjnë një burim jetik për jetën në Tokë, pasi ato janë depozita më e madhe e ujit të freskët në gjendje të lëngët në planetin tonë (Fettër 2001). Van Engelenburg et al. (2018) kanë evidentuar ndikimin e ndryshimeve klimatike në nivelet e ujërave nëntokësore, ndërsa Taylor et al. (2013) treguan se ndryshimet klimatike globale kanë potencialin të ndikojnë në sasinë dhe cilësinë e ujërave nëntokësore. Një pjesë e

rëndësishme e ujërave nëntokësore janë ujërat karstikë të cilët lidhen me shkëmbinj të tretshëm, si gëlqërorët dhe evaporitet. Shkëmbinj të karstikë përbëjnë 24 % të territorit të Shqipërisë nga të cilët 6,500 km² janë shkëmbinj karbonatikë të Triasikut – Jurasikut – Kretakut dhe Paleocen – Eocenit, ndërsa 260 km² përbëhen nga evaporitet të Permo – Triasikut (Eftimi 2019).

Në juglindje të Shqipërisë, përgjatë kufirit me Maqedoninë e Veriut dhe Greqinë, ndodhen liqenet e Prespës dhe Ohrit, të cilët formojnë një sistem hidrologjik të ndërlidhur, që është nën presionin e vazhdueshëm të ndryshimeve klimatike. Për studimin e ndikimit të këtyre ndryshimeve klimatike, janë kryer studime të ndryshme që kanë pasur si objekt rënien e nivelit të ujit në liqenin Prespa e Madhe, lidhjen hidraulike midis Liqenit Prespa e Madhe dhe Ohër, kontributin e ujit të Liqenit Prespa e Madhe në ujëdhënien e burimeve që dalin përgjatë bregut të liqenit Ohër, ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tyre në hidrologjinë e sistemit ujqor Prespë Ohër (Popovska & Bonacci 2007; Leng et al. 2023; Schriek & Giannakopoulos 2017). Humbjet e ujit nga liqeni Prespa e Madhe i detyrohen kryesisht avullimit nga sipërfaqja e liqenit dhe drenimit nëpërmjet kanaleve nëntokësore karstik në Liqenin e Ohrit (Eftimi 2019).

Cvijic (1906) hodhi për herë të parë idenë e shkarkimit të ujërave të Liqenit Prespa e Madhe në Liqenin Ohër, ndërsa kohët e fundit kjo ide është konfirmuar përmes përdorimit të metodave të gjurmuesve natyralë (Eftimi et al. 2021) dhe artificialë (Popov et al. 2009). Ky studim, përmes një kampionmarrje përfaqësuese që shtrihet në dy stinë (pranverë, vjeshtë) synon të hedh dritë mbi origjinën e ujërave të burimeve, mekanizmat e rimbushjes së rezervave nëntokësore, ndikimin e ndryshimeve klimatike në ciklin hidrologjik, si dhe të vlerësohen risqet për burimet e qëndrueshme të ujit në të ardhmen.

NDËRTIMI GJEOLOGJIK

Zona e studimit

Rajoni Ohër – Prespë përfaqëson pellgun më të vjetër të ujërave të brendshme në Evropë dhe ndër më të vjetrit në botë, që daton që nga Plioceni, 3 – 5 milion vjet më parë (Krstic 2012). Zona në studim përfshin sistemin karstik të liqeneve ndërkufitarë Prespa e Vogël, Prespa e Madhe dhe Ohër (Krstic 2012), të cilët përbëjnë një sistem të përbashkët hidraulik (Eftimi 2019). Liqenet Prespa e Madhe dhe Prespa e Vogël janë zonat më të thella të një pellgu të brendshëm malor, i cili nuk ka dalje natyrore të ujit në sipërfaqe. Lidhja hidraulike midis tyre sigurohet vetëm me anë të rrjedhjeve nëntokësore nëpërmjet të cilave uji i Liqenit Prespa e Madhe (afërsisht 849 m mbi nivelin e detit) drenon drejt perëndimit në Liqenin e Ohrit, afërsisht 150 metra më ulët (Krstic 2012). Prespa e Vogël dhe Prespa e Madhe janë të ndara nga një rrip tokësor me formime aluviale (istmus).

Në vitin 1969, nga shteti Grek është ndërtuar një digë që kontrollon rrjedhjen e ujit nga Prespa e Vogël në Prespa e Madhe. Liqenet Prespa e Vogël, Prespa e Madhe dhe Ohër kanë përkatësisht sipërfaqe 47,4, 274, dhe 348 km², dhe thellësi maksimale 8, 54 dhe 288m (Eftimi et al. 1985).

Rajoni Ohër – Prespë përfshin shkëmbinj metamorfike paleozoikë deri të shkëmbinj të sedimentarë të Neogjenit dhe Kuaternarit (Micevski 2000). Në veçanti, vargmali Mali i Thatë – Galiçicë është ndërtuar kryesisht nga shkëmbinj gëlqërorë masivë, të Triasikut të Sipërm – Jurasikut të Poshtëm, dhe më pak

nga gëlqërorë të Kretakut të Sipërm. Sipas Vranai et al. (1997) and Xhomo et al. (2002) trashësia e përgjithshme e depozitmeve karbonatike Triasiko – Jurasike arrin rreth 1,000 - 1,200 m. Dalje të vogla të konglomeratëve gëlqërorë të Eocenit zhvillohen kryesisht në pjesën jugore të zonës (Eftimi & Zoto 1997).

Relievi i Malit të Galiçicës karakterizohet kryesisht nga zhvillimi i formave karstike, të tilla si gropa karstike dhe fusha të sheshta karstike (Micevski 2000). Fundi i Liqenit të Prespës është kryesisht i mbuluar nga depozitime të epokës së Pliocenit të përfaqësuar nga argjila, ranorë dhe konglomeratë që zbulohen edhe përgjatë anës së liqenit (Eftimi & Zoto 1997). Zona e studimit është pjesë e zonës së brendshme të rrudhosjes alpine e cila ka përjetuar proçese të konsiderueshme tektonike gjatë intervalit kohor Pliocen – Kuaternar (Meçe & Aliaj 2000; Melo 2001; Tëmovski 2016), të tilla si ngritja e fortë dhe progresive që çoi në formimin e horstit Mali Thatë – Galiçicë, ndersa në të dy anët e tij shtrihen grabenë të mëdhenj të përfaqësuar nga Liqeni i Prespës në lindje, dhe Liqeni i Ohrit dhe Fusha e Korçës në perëndim. Pellgu i Liqenit të Ohrit ndodhet në kontaktin midis Zonës Ofiolitë të Mirditës dhe Zonës së Korabit, kontakti midis të cilave verehet në jug të Gadishullit të Linit dhe në bregun perëndimor të liqenit. Zona e Korabit në këtë rajon përbëhet kryesisht nga shkëmbinj paleozoikë metamorfik dhe magmatikë, të cilët ndertojnë një strukturë antiklinale në zonën midis liqeneve të Prespës dhe Ohrit (Hoffmann et al. 2012).

Hidrogeologjia

Në juglindje të Shqipërisë, në kufi me Maqedoninë e Veriut dhe Greqinë, liqenet e Prespës dhe Ohrit përbëjnë një sistem të përbashkët hidraulik (Eftimi 2019). Daljet e ujit nga liqeni Prespa e Madhe i detyrohen kryesisht infiltrimeve nëntokësore karstike drejt Liqenit të Ohrit (Eftimi 2019) dhe, në një shkallë më të ulët, avullimit nga sipërfaqja ujore e liqenit dhe pompimit të ujit për nevoja të komunitetit që banon buzë liqenit (Beqiraj 2018). Në anën perëndimore të vargmalit Galiçicë/Mali i Thatë dalin burime të shumta karstike të cilët shkarkohen në Liqenin e Ohrit. Burimet që dalin në lartësi hipsometrike mbi pasqyren e ujit në Liqenin Prespa e Madhe, i detyrohen plotësisht ujit karstik që ushqehet direkt nga reshjet që bien në majat e maleve. Me anën e gjurmuesëve është zbuluar se burimet e Tushemishtit (2.5 m³/s) në Shqipëri dhe Shën Naumit (7.5 m³/s) në Maqedoni ushqehen pjesërisht nga Liqeni Prespa e Madhe (Matzinger et al. 2006).

Që në fillim të shekullit XX, gjeografi Jovan Cvijić dha një përshkrim të detajuar të fenomenëve karstike në zonën e liqeneve të Prespës dhe Ohrit dhe formuloi hipotezën e ushqimit të burimeve të Shën Naumit dhe Tushemishtit nga Liqeni i Prespës (Cvijic 1906). Fenomeni më i rëndësishëm karstik i zonës është ujëthithësi i Zaverit, që ndodhet në bregun perëndimor të liqenit të Prespës midis fshatrave Goricë e Vogël dhe Gollomboç (në territorin shqiptar), ku uji i Liqenit të Prespës zhduket për t'u rishfaqur në burimet e mëdha karstike përgjatë bregut të liqenit të Ohrit (Eftimi et al. 1985; Eftimi 2019).

Hidrologjia

Rajoni i Prespës dhe Ohrit ndodhet në zonën e tranzicionit midis klimave mesdhetare dhe kontinentale, me verë të ngrohtë dhe të thatë dhe dimra mjaft të ftohtë dhe të lagësht (Schriek & Giannakopoulos 2017). Zona e Prespës përfshin liqenet Prespa e Vogël dhe Prespa e Madhe, dhe përrenj të tipit malor, me rrjedhje të përhershme ose sezonale, përgjatë shpateve të pjerrëta dhe me bimësi (Krstic 2012), të cilët derdhen në të dy liqenet. Në anën shqiptare të pellgut nuk identifikohen rrjedhje sipërfaqësore që kontribuojnë drejtpërdrejt në furnizimin e Liqenit të Prespës së Vogël. Një veçori e rëndësishme hidrologjike e Liqenit Prespa e Madhe është mungesa e daljeve sipërfaqësore natyrore dhe gati gjysma e shkarkimit të ujit behet përmes akuiferit karstik dhe del në perëndim në formën e burimeve, të cilat derdhen në Liqenin e Ohrit (Cvijic 1906). Relievi bashkë me aktivitetin tektonik ende aktiv, kanë përcaktuar një gradient shumë të lartë (0.0159 osë 1.59%) hidraulik të ujit që kullon shumë shpejt në masivin karstik (Micevski 2002).

Aktiviteti njerëzor ka modifikuar konsiderueshëm hidrologjinë e zonës:

devijimi i përroit të Agios Germanos (në Greqi) nga Prespa e Vogël në Prespë të Madhe në vitin 1936, devijimi i lumit Devoll (në Shqipëri) dhe shkarkimi i tij në Liqenin Prespa e Vogël në mesin e viteve 1970. Përpara viteve 1970, proceset e erozionit dhe depozitimit formuan një istmus aluvial midis Liqenit Prespa e Vogël dhe Prespa e Madhe të cilat pësuan ndryshime të njëkohëshme në vëllim dhe sipërfaqe. Në vitet 1969/70, lidhja midis Prespës së Vogël dhe Prespës së Madhe u transformua më tej duke shtuar një digë në fshatin Mileonas (Greqi), dhe dy liqenet u lidhën përmes një kanali betoni me një kokë hidraulike prej 3 m (Hollis & Stevenson 1997).

Niveli i ujit në Liqenin Prespa e Madhe luhetet përmes stinëve dhe përgjatë viteve. Niveli maksimal historik i regjistruar në liqenin e Prespës së Madhe është në vitin 1993 prej 852.91 m. Në vitet 2002 – 2005 liqeni arriti nivelin prej rreth 844.5 m mbi nivelin e detit, nivel që përfaqëson nivelin më të ulët historik (Eftimi 2019). Në tabelen 1 jepet niveli i ujit në Liqenin Prespa e Madhe gjatë vitit 2024 (të dhëna të mara nga Instituti i Gjeoshkencave, 2024), ku shihet qartë që kemi një ulje në krahasim me nivelin historik minimal për ketë liqen.

Tabela 1 – Vlerat mesatare mujore dhe vjetore e nivelit të ujit (m) në Liqenin Prespa e Madhe, për vitin 2024 (Instituti i Gjeoshkencave, 2024).

| Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Mesatare Vjetore |
|--------|--------|--------|--------|--------|---------|--------|--------|---------|--------|--------|---------|------------------|
| 844.52 | 844.56 | 844.61 | 844.66 | 844.74 | 844.69 | 844.53 | 844.32 | 844.21 | 844.09 | 844.01 | 844.02 | 844.41 |

METODOLOGJIA

Për të kuptuar më mirë dinamikën hidrologjike dhe ndikimin e ndryshimeve klimatike në sistemin hidrologjik të liqeneve Prespa e Madhe – Ohër, u realizua një kampionmarrje përfaqësuese (Fig. 1), në kohë dhe në hapësirë. Në aspektin hapësinor, u kampionuan gjithë komponentët kryesorë hidrologjikë: (1) liqenet Prespa e Madhe dhe Ohër dhe (2) burimet karstike që dalin në anën perëndimore të vargmalit “Mali i Thatë – Galiçicë”. Kampionimi

sezonal ka për qëllim të evidentojë ndryshimet modeste në karakteristikat fiziko-kimike të ujit. Kampionimi i gjithë tipeve të pikave ujore, ka mundësuar ndërtimin e një profili të zgjeruar të variabilitetit hapësinor të karakteristikave hidrokimike. Pikat ujore janë përcaktuar nëpërmjet një analize të thelluar të hartave topografike, hidrologjike, hidrogeologjike dhe njohuri të thella të ekosistemit. Mostrat u morën në shishe plastike me vëllim 1.5 l, të shpëlara më parë me ujin përkatës të kampionimit.




Figura 1. Vendodhjet e pikave ujore të kampionuara në hartën Google.

Për një vlerësim sasior të shkallës së përzierjes të ujit të karstit me ujin e liqenit Prespa e Madhe në ujin e burimeve, u përdor modeli i përzierjes me dy komponentë i cili konsiston në zgjidhjen e sistemit me dy ekuacione, ku ekuacioni i parë është bilanci i masës të fraksioneve ujorë të përzieria, ndërsa ekuacioni i dytë është bilanci kimik i përmbajtjes së klorureve në ujë (Herczeg & Edmunds 2000).

$$f_k + f_l = f_b = 1$$

$$Cl_k * f_k + Cl_l * f_l = Cl_b * f_b$$

ku:

- f_k dhe f_l janë përkatësisht fraksionet ujore të karstit dhe liqenit në ujin e burimeve f_b
- Cl_k , Cl_l dhe Cl_b janë respektivisht përmbajtjet e klorureve në ujin e karstit, liqenit dhe burimeve

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Të dhënat e analizave fiziko – kimike të ujërave të Liqenit të Ohrit dhe të Prespës si dhe të burimeve karstike në perëndim të malit të Thatë- Galicicë (Tabs. 2 & 3) janë përpunuar nëpërmjet programit AquaChem. Me anën e diagramave Piper dhe Schoeller janë vizualizuar karakteristikat hidrokimike dhe janë krahasuar tiparet kryesore të përbërjes kimike të ujërave të kampionuar. Kjo qasje ka mundësuar një analizë të thelluar të gjendjes kimike të ujërave dhe marrëdhënieve midis burimeve të ndryshme ujore në rajon. Eftimi et al. (2021) kanë dalluar vetëm tipin hidrokimik Ca-HCO₃ dhe e kanë argumentuar me dominimin në zonën e studimit e shkëmbinjve

karbonatike – gëlqerore, ndërsa në diagramat Piper (Fig. 2) dhe Scholler (Fig. 3) vërehet qartë prania e dy tipeve hidrokimike të ujit: Ca-HCO₃ (rrathe të kuq) dhe Ca-Mg-HCO₃ (trekendesha blu).

Në tipin hidrokimik Ca-HCO₃ përfshihen ujërat e burimeve Biljana, Tushemisht, Shëngjergj, Pusi GM_2028, Elshan dhe Alarup (keta dy të fundit me dalje mbi kuotën maksimale të pasqyres së liqenit Prespa e Madhe), ndërsa në tipin Ca-Mg-HCO₃ përfshihen ujërat e liqenit Prespa e Madhe dhe Ohër, e burimeve Gurras, Sh. Naum, Pojan, Përrenjas, Lubanisht, Zvezde (Figs. 2 & 3).

Uji i burimit Kufi është i tipit hidrokimik Ca-HCO₃ në provemarrjen e muajit Qershor dhe i tipit Ca-Mg-HCO₃ në provemarrjen e muajit Tetor. Kiri (2021) dallon gjithashtu dy tipe hidrokimike të ujërave të burimeve, por në dallim me gjetjet e këtij studimi është përkatësia në tipin Ca-HCO₃ e ujit të liqenit Prespa e Madhe. Ujërat e tipit Ca-HCO₃ kanë përgjithësisht vlera më të ulëta të Mineralizimit të Përgjithshëm (MP < 300mg/l) dhe variojnë në kufij të ngushtë ($\sigma_{MP} = 16.74\text{mg/l}$) që tregojnë përkatësisht për kohën e kontaktit ujë-shkëmb më të shkurtër dhe qarkullim të ujërave nëntokësore në mjedis litologjikisht “homogjen” – gëlqerore.

Nga ana tjetër, ujërat e tipit Ca-Mg-HCO₃ dallohen për vlera më të larta të Mineralizimit të Përgjithshëm (MP > 300mg/l) që variojnë në kufije të gjere ($\sigma_{MP} = 110.39\text{mg/l}$), çka pasqyrohet në një variacion më të dukshëm të përmbajtjes së kationëve dhe anioneve kryesore (Figs. 2 & 3). Përjashtim bën pusi GH_2018 i shpuar

me thellësi nën kuotën e drenimit të ujërave nëntokesore në liqenin e Ohrit (Beqiraj 2018).

Ndryshimi në përbërjen kimike të ujërave midis burimeve është evidentuar edhe nga Eftimi et al. (2021), por bën përshtypje që ujërat me MP me të lartë (Tabs. 1 & 2) u përkasin burimeve që dalin në

kuota mbi nivelin e ujit në liqenin Prespa e Madhe si burimi i Pojanit (Z=950m), i Alarupit (Z=1070m) dhe i Zvezdes (Z=856m). Në kontrast me variacionin hapësinor në përbërjen kimike të ujërave të burimeve, nuk vërehet ndonjë ndryshim i ndjeshëm në përbërjen kimike të ujërave të kampionuar në Qershor dhe Tetor, 2024.




Figura 2. Diagrama Piper e përbërjes kimike të ujërave të rajonit Prespa e Madhe – Ohër (bojëqjelli: liqeni Prespa e Madhe, liqeni Ohër, Gurras, Sh. Naum, Pojan, Prenjas, Lubanisht, Zvezde; rrathet e kuqe: Biljana, Elshan, Tushemisht, Pusi GM_2028, Shengjergj, Alarup; Burimi Kufi ka përkatësi të dyfishte).

Tabela 2 – Rezultatet e analizave fiziko – kimike, Qershor 2024 (gjithë parametrat jepen në mg/l; EC në $\mu\text{S}/\text{cm}$; FP në grade gjermanë).

| Vendmarrja | Parametri | | | | | | | | | | | | | | |
|---------------|-----------|------|------|------|------|-------------------------------|------------------------------|-----------------|----------------|------------------|------------------|-------------------------------|------------------|-------|--------|
| | EC | pH | TC | TN | Cl- | SO ₄ ²⁻ | NO ₃ ⁻ | Na ⁺ | K ⁺ | Ca ²⁺ | Mg ²⁺ | HCO ₃ ⁻ | SiO ₂ | FP | MP |
| Lin-Ohër | 244 | 7.73 | 2.14 | 0.19 | 6.2 | 8.26 | 0.13 | 7.33 | 0.29 | 36.07 | 7.9 | 140.35 | 0.15 | 6.86 | 210.15 |
| B. Bijana | 286 | 7.28 | 1.53 | 0.51 | 2.65 | 3.41 | 2.59 | 5.08 | 0.52 | 59.11 | 0.6 | 183.06 | 0.34 | 8.4 | 257.02 |
| B. Elshan | 299 | 7.21 | 1.94 | 0.28 | 3.54 | 4.55 | 1.18 | 3.21 | 0.6 | 60.11 | 2.43 | 189.16 | 0.9 | 8.96 | 264.79 |
| B. Lubanisht | 412 | 7.13 | 3.1 | 0.32 | 3.54 | 3.98 | 1.45 | 4.07 | 0.46 | 68.13 | 13.36 | 268.49 | 1.1 | 12.56 | 363.53 |
| B. Shën Naum | 314 | 7.14 | 1.32 | 0.48 | 5.21 | 4.44 | 2.22 | 4.45 | 0.15 | 47.09 | 11.94 | 198.37 | 0.83 | 9.33 | 273.87 |
| B. Kuffi | 325 | 7.38 | 1.14 | 0.42 | 4.43 | 3.89 | 2.1 | 4.73 | 0.36 | 57.11 | 6.78 | 205.47 | 0.97 | 9.54 | 284.87 |
| Tush-Ohër | 241 | 8.04 | 2.19 | 0.18 | 6.2 | 8.46 | 0.1 | 3.73 | 0.17 | 33.06 | 10.52 | 134.25 | 0.05 | 7.04 | 199.5 |
| B. Tushemisht | 340 | 7.33 | 1.67 | 0.46 | 5.11 | 5.09 | 2.28 | 5.13 | 0.49 | 59.11 | 6.98 | 205.47 | 0.73 | 9.87 | 292.76 |
| B. Gurras | 317 | 7.45 | 1.6 | 0.47 | 5.21 | 4.03 | 2.4 | 4.38 | 0.37 | 50.09 | 10.12 | 200.37 | 0.73 | 9.33 | 276.97 |
| Gar. Vog - PM | 247 | 8.15 | 4.38 | 0.36 | 7.09 | 12.97 | 0.34 | 6.57 | 0.18 | 29.05 | 10.93 | 125.14 | 0.17 | 6.57 | 195.31 |
| B. Pojan | 616 | 7.31 | 2.02 | 0.5 | 6.2 | 11.48 | 2.65 | 5.78 | 0.22 | 67.13 | 37.45 | 378.42 | 4.19 | 18 | 509.33 |
| B. Përrenjas | 331 | 7.61 | 1.25 | 0.52 | 4.43 | 3.53 | 2.55 | 2.46 | 0.01 | 53.1 | 10.33 | 205.48 | 0.78 | 9.8 | 281.89 |

Tabela 3 – Rezultatët e analizave fiziko – kimike, Tetor 2024.

| Vendmarrja | Parametri | | | | | | | | | | | | | | |
|---------------|-----------|------|------|-------|-------|-------------------------------|------------------------------|-----------------|----------------|------------------|------------------|-------------------------------|------------------|-------|--------|
| | EC | pH | TC | TN | Cl- | SO ₄ ²⁻ | NO ₃ ⁻ | Na ⁺ | K ⁺ | Ca ²⁺ | Mg ²⁺ | HCO ₃ ⁻ | SiO ₂ | FP | MP |
| Lin-Ohër | 220 | 7.9 | 3.08 | 0.17 | 5.76 | 7.53 | <0.1 | 4.79 | 0.43 | 29.58 | 10.33 | 128.12 | 0.05 | 6.51 | 189.65 |
| B. Biljana | 285 | 7.22 | 2.17 | 0.4 | 2.22 | 2.92 | 2.01 | 2.46 | 0.29 | 58.14 | 1.82 | 183.06 | 0 | 8.54 | 252.94 |
| B. Elshan | 296 | 7.08 | 2.54 | 0.32 | 3.1 | 4.26 | 1.68 | 2.51 | 0.31 | 58.14 | 3.65 | 189.16 | 0.56 | 8.96 | 262.84 |
| B. Lubanisht | | | | | | | | | | | | | | | |
| B. Shën Naum | 310 | 7.29 | 3.48 | 0.46 | 4.43 | 4.18 | 2.08 | 5.25 | 1.1 | 54.06 | 5.77 | 193.43 | 0 | 8.88 | 270.31 |
| B. Kufi | 320 | 7.27 | 2.55 | 0.41 | 5.32 | 3.86 | 2.04 | 3.16 | 0.33 | 54.06 | 9.11 | 200.15 | 0.51 | 9.65 | 278.04 |
| Tush-Ohër | 234 | 7.68 | 3.08 | 0.21 | 5.76 | 7.23 | 0.15 | 2.76 | 0.31 | 32.64 | 10.33 | 134.24 | 0 | 6.94 | 195.02 |
| B. Tushemisht | 336 | 7.17 | 3.09 | 0.46 | 5.85 | 4.56 | 2.26 | 5.57 | 0.58 | 57.12 | 7.29 | 207.47 | 0.1 | 9.66 | 290.73 |
| B. Gurras | 312 | 7.21 | 2.8 | 0.47 | 4.96 | 3.58 | 2.34 | 5.23 | 0.61 | 49.98 | 8.87 | 195.26 | 0.24 | 9.02 | 270.84 |
| Gar. Vog - PM | 241 | 7.89 | 4.46 | 0.43 | 8.33 | 12.6 | 0.35 | 6.54 | 0.72 | 30.6 | 9.36 | 128.14 | 0.61 | 6.43 | 196.84 |
| B. Pojan | 596 | 7.52 | 3.47 | 0.52 | 6.74 | 10.6 | 2.84 | 8.18 | 0.97 | 60.18 | 42.53 | 390.53 | 5.49 | 18.2 | 522.59 |
| B. Përrenjas | 318 | 7.57 | 1.64 | 0.44 | 4.87 | 3.03 | 2.35 | 1.63 | 0.18 | 54.06 | 9.72 | 201.37 | 0.93 | 9.79 | 277.24 |
| Pustec - PM | 242 | 7.83 | 4.69 | 0.35 | 7.98 | 11.95 | 0.39 | 6.16 | 0.69 | 28.56 | 12.15 | 134.24 | 0.27 | 6.79 | 202.26 |
| Pusi GM_2018 | 539 | 7.23 | 3.85 | 3.47 | 6.56 | 5.98 | 18.53 | 5.54 | 0.63 | 106.08 | 4.86 | 323.41 | 1.41 | 15.94 | 471.61 |
| Zvezde | 611 | 7.13 | 4.64 | 7.42 | 9.75 | 21.1 | 39.23 | 21.72 | 2.48 | 72.42 | 20.66 | 305.1 | 1.39 | 14.87 | 492.49 |
| Shëngjergj | 344 | 7.32 | 3.36 | 4.07 | 7.09 | 11.52 | 21.15 | 6.21 | 0.69 | 54.47 | 8.87 | 176.96 | 0.05 | 9.65 | 287.09 |
| Alarup | 774 | 7.02 | 2.76 | 19.75 | 32.79 | 19.31 | 107.45 | 12.08 | 1.49 | 130.56 | 10.94 | 299 | 0.41 | 20.76 | 189.65 |

Kjo qëndrueshmeri në kohe e përbërjes kimike e ujërave të burimeve është shpjeguar me ushqimin e burimeve nga një pellg ujërash nëntokësore jashtëzakonisht i madh (Jordanovska et al. 2010), ose me proceset e përzierjes të ujërave të karstit me ujin e liqenit Prespa e Madhe (Eftimi et al. 2021). Nga figura 3 del se nga ana sasiore ujërat e burimeve që dalin në anën përendimore të masivit karbonatik Mali i Thatë – Galiçicë, janë

një përzierje, në raport të ndryshme, e ujit të karstit me ujin e liqenit Prespa e Madhe. Ujërat e tipit Ca-HCO₃ janë të lidhur kryesisht me reshjet – karstin dhe paraqesin variacion të ngushtë në përberje, ndërsa ujërat e tipit Ca-Mg-HCO₃ tregojnë për një kontribut më të ndjeshëm të ujit të liqenit Prespa e Madhe kundrejt ujit të karstit dhe shfaqin dukshëm variacion më të gjerë të Mg, K, Na dhe SiO₂ (Fig. 3).




Figura 3. Diagrama Scholler e përbërjes kimike të ujërave të rajonit Prespa e Madhe – Ohër (pikat figurative si në Fig. 2).

Kloruret janë specie kimike inertë (jone konservative) në ujërat nëntokësore (Herczeg & Edmunds 2000) prandaj mund të përdoren si gjurmues për të kuptuar ritmet e ngarkimit dhe përzierjen midis ujërave. Për me të pë,

kloruret kanë lëvizshmëri të lartë në ujë, të ngjashme me atë të molekulave të ujit (Hill 1984) dhe nuk janë të angazhuar në reaksionet e zakonshme kimike që ndodhin në ujin nëntokësor (Leibundgut et al. 2009). Për me të pë,

një specie kimike si kloruret ndikohet vetëm nga avullimi pranë sipërfaqes së tokës dhe është i vlefshëm sepse integrohet në shkallë të gjata kohore (Cook & Herczeg 2000).

Si përfaqësues i ujit të karstit u zgjodh burimi i Biljanës sepse ndodhet rreth 12km në veri të ekstremit verior të Liqenit Prespa e Madhe, pra është jashtë ndikimit të mundshëm të tij, çka duket në përmbajtjen me të ulet të klorureve dhe magnezit (Tabs. 2 & 3). Në provëmarrjen e muajit Qershor (Tab. 4) shihet qartë që burimet Elshan, Kufi dhe vetë Biljana ushqehen në masën mbi 50% nga uji i karstit, ndersa tre burimet e tjerë nga uji i liqenit Prespa e Madhe. Gjetje interesante është që, në provëmarrjen e muajit Tetor, kontributi i ujit të karstit në të gjashtë burimet është dukshëm në masën mbi 50%. Kjo provëmarrje u krye pas një periudhe kohore rreth 3 muaj pa reshje, që shoqërohet me rënien e ndjeshme të nivelit të ujit në liqenin Prespa e Madhe dhe daljen mbi ujë të disa çarjeve karstike

ujëthithëse (psh, Zaveri), të cilat nuk mund të përcjellin ujë nga liqeni Prespa e Madhe drejt burimeve të Ohrit. Rezultatet e mësipërme të kontributit të ujit të karstit dhe Liqenit Prespa e Madhe në ujin e burimeve që dalin buzë liqenit te Ohrit, janë të afërta me rezultatet e modelit të përzierjes me dy komponentë, sipas përbërjes izotopike të O-18 dhe H-2 në ujë (Eftimi et al. 2021).

Nga ana e përbërjes kimike të ujit të burimeve, kjo mbështetet me rënien e përmbajtjes së Mg (Tab. 2) dhe silices (Tab. 4, Fig. 4) në ujërat e marra në muajin Tetor. Burimi i silices në ujin e burimeve nuk mund të jetë nga karsti, ndërsa prania e tij në ujin e liqenit Prespa e Madhe lidhet me proceset e tjetërsimit të mineraleve silikate të shkëmbinjve metamorfike që përhapen në lindje dhe veri të liqenit. Prandaj me rënien e kontributit të ujit të liqenit Prespa e Madhe, bie edhe përmbajtja e silices së tretshme në ujin e burimeve.

Tabela 4 – Kontributi në % i ujit të liqenit Prespa e Madhe (f_l) dhe ujit të karstit (f_k) në ujin e burimeve (sipas përmbajtjes së klorureve në ujë).

| Koha e mostrimit | Qershor, 2024 | | Tetor, 2024 | |
|---------------------|---------------|-------|-------------|-------|
| | f_l | f_k | f_l | f_k |
| Fraksioni ujqor (%) | f_l | f_k | f_l | f_k |
| Elshan | 20 | 80 | 14 | 86 |
| Sh.Naum | 58 | 42 | 36 | 64 |
| Kufi | 40 | 60 | 36 | 64 |
| Tushemisht | 55 | 45 | 47 | 53 |
| Gurras | 58 | 42 | 45 | 55 |




Figura 4. Variacioni i përmbajtjes së SiO₂ në ujërat nëntokesore të disa burimeve, për mostrat e marra në Qershor dhe Tetor, 2024.

PËRFUNDIME

Rajoni Ohër – Prespë përfaqëson një ekosistem ujqor me interes nga ana hidrologjike – hidrogeologjike, ku pasojat e ndryshimeve klimatike janë të ndjeshme, veçanërisht në rënien e nivelit të ujit në Liqenin Prespa e Madhe, i cili arriti në Nëntor 2024 nivelin më të ulët historik prej 844.01 m. Gëlqerorët Triasiko - Jurasike ndërtojnë vargmalin Mali i Thatë-Galiçicë, shistet paleozoike zhvillohen kryesisht në lindje dhe veri të liqenit Prespa e Madhe, ndersa shkëmbinjte ultrabazike dalin në perëndim e veriperëndim të liqenit Ohër.

Ujërat e kampionuar i përkasin dy tipeve hidrokimike të ujit: Ca-HCO₃ (mbizotërim i komponentit karstik) dhe Ca-Mg-HCO₃ të cilat janë kryesisht të lidhura me liqenin Prespa e Madhe. Përdorimi i klorureve për vlerësimin sasior të shkallës së përzierjes të ujit të karstit me ujin e liqenit Prespa e Madhe në ujin e burimeve tregoi që, në stinen e pranverës, burimet Elshan,

Kufi dhe Biljana ushqehen në masën mbi 50% nga uji i karstit, ndërsa në atë të vjeshtës, edhe burimet Tushemisht, Gurras dhe Shën Naum ushqehen në mbi 50% nga karsti.

Përmbajtja e silices (element kimik jo-karstik) në ujin e burimeve ulet ndjeshëm në muajin Tetor kundrejt muajit Qershor, ndërkohë që rritet në ujin e liqenit Prespa e Madhe, rikonfirmon mbizotërimin e komponentit karstik kundrejt Liqenit Prespa e Madhe në ushqimin e burimeve në periudhat e tejzgjatura pa reshje.

Falënderime. Ky studim përbën një komponent të rëndësishëm të tezës së doktoraturës së autores, e cila po zhvillohet në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, pranë Departamentit të Shkencave të Tokës, Tiranë, Shqipëri. Shpreh mirënjohjen dhe falënderim ndaj Drejtorit të IGJEO-së Prof. Dr. Ylber Muçeku dhe Shefit të Departamentit të Gjeologjisë Prof. Dr. Ibrahim Milushi për mbështetjen e tyre profesionale, si dhe për vënien në dispozicion të të

dhënave të domosdoshme për realizimin e këtij studimi. Gjithashtu, një falënderim i veçantë është për kolegen time hidrogjeologene Dr. Emanuela Kiri, për bashkëpunimin dhe ndihmën e dhënë gjatë punës në terren dhe diskutimet shkencore përgjatë procesit kërkimor. Gjithashtu, falënderojmë ekspertin i jashtëm për sugjerimet e bera lidhur me korrjigjimit e këtij artikullit.

REFERENCA

- ALAM S., GEBREMICHAEL M., LI R., DOZIER J. & LETTENMAIER D.P. (2019).** CLIMATE CHANGE IMPACTS ON GROUNDWATER STORAGE IN THE CENTRAL VALLEY, CALIFORNIA. *CLIMATE CHANGE*, 157, 387–406.
- BAKALOWICZ M. (2015).** KARST AND KARST GROUNDWATER RESOURCES IN THE MEDITERRANEAN. *ENVIRONMENTAL EARTH SCIENCES*, 74, 5–14.
- BEQIRAJ A. (2018).** STUDIM HIDROGJEOLGIK MBI MUNDËSINË E FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM TË FSHATIT GORICË E MADHE, ME ANË TË NJË PUS-SHPIMI HIDROGJEOLGIK. *BASHKIA PUSTEC*, p. 30.
- COOK P.G. & HERCZEG A. L. (2000).** ENVIRONMENTAL TRACERS IN SUBSURFACE HYDROLOGY; p. 534. DOI 10.1007/978-1-4615-4557-6
- CVIJIC J. (1906).** FUNDAMENTAL OF GEOGRAPHY AND GEOLOGY OF MACEDONIA AND SERBIA; SPECIAL EDITION, VIII+680; *SERBIAN ROYAL ACADEMY*, BELGRADE, SERBIA. (IN SERBO-CROATIAN).
- EFTIMI R. (2019).** THE CATASTROPHIC DECREASE OF PRESAPA LAKE LEVEL—RESULT OF NATURAL OR ANTHROPOGENIC REASON? *REVIEW OF THE BULGARIAN GEOLOGICAL SOCIETY*, 80, 215–217.
- EFTIMI R., ANDREYCHOUK V., SZCZYPEK T. & PUCHEDJDA W. (2019).** KARST SPRINGS OF ALBANIA AND THEIR MANAGEMENT. *ACTA GEOGRAFICA SILESIANA*, 13/2, 39–56.
- EFTIMI R., BISHA G., TAFILAJ I. & SHEGANAKU XH. (1985).** *HYDROGEOLOGICAL MAP OF ALBANIA*, SCALE 1:200 000, TIRANA.
- EFTIMI R. & ZOTO J. (1997).** ISOTOPE STUDY OF THE CONNECTION OF OHRID AND PRESAPA LAKES. *INTERNATIONAL SYMPOSIUM "TOWARDS INTEGRATED CONSERVATION AND SUSTAINABLE DEVELOPMENT OF TRANSBOUNDARY MACRO AND MICRO PRESAPA LAKES"*, KORCHA, ALBANIA; p. 32–37.
- EFTIMI R., STEVANOVIĆ Z. & STOJOV V. (2021).** HYDROGEOLOGY OF MALI THATË–GALIČICA KARST MASSIF RELATED TO THE CATASTROPHIC DECREASE OF THE LEVEL OF LAKE PRESAPA. *ENVIRONMENTAL EARTH SCIENCES*, 80, p. 708.
- FLEMING S.W. & QUILTY E.J. (2006).** AQUIFER RESPONSES TO EL NIÑO SOUTHERN OSCILLATION, SOUTHWEST BRITISH COLUMBIA. *GROUND WATER*, 44, 595–599.
- FORD D.C. & WILLIAMS P.W. (2007).** KARST HYDROGEOLOGY AND GEOMORPHOLOGY. *JOHN WILEY & SONS, CHICHESTER*.
- FU G., CROSBIE R.S., BARRON O., CHARLES S.P., DAWES W., SHI X., VAN NIEL T. & LI C. (2019).** ATTRIBUTING VARIATIONS OF TEMPORAL AND SPATIAL GROUNDWATER RECHARGE: A STATISTICAL ANALYSIS OF CLIMATIC AND NON-CLIMATIC FACTORS. *JOURNAL OF HYDROLOGY*, 568, 816–834.
- HEM J.D. (1992).** STUDY AND INTERPRETATION OF THE CHEMICAL CHARACTERISTICS OF NATURAL WATER, 3RD EDITION. *US GEOLOGICAL SURVEY WATER-SUPPLY PAPER 2254*, WASHINGTON, DC.
- HERCZEG A.L. & EDMUNDS W.M. (2000).** INORGANIC IONS AS TRACERS. IN ENVIRONMENTAL TRACERS IN SUBSURFACE HYDROLOGY. EDS. PETER G. COOK AND ANDREW L. HERCZEG. *SPRINGER SCIENCE + BUSINESS MEDIA*, NEW YORK, 43–89.

- HILL D. (1984).** DIFFUSION COEFFICIENTS OF NITRATE, CHLORIDE, SULPHATE AND WATER IN CRACKED AND UNCRACKED CHALK. *EUROPEAN JOURNAL OF SOIL SCIENCES*, 35, 27-33.
- HOFFMANN N., REICHERTER K., GRUTZNER C., HURTGEN J., RUDERSDORF A., VIEHBERG F.A. & WESSELS M. (2012).** QUATERNARY COASTLINE EVOLUTION OF LAKE OHRID (MACEDONIA/ALBANIA). *CENTRAL EUROPEAN JOURNAL OF GEOSCIENCES*, 4(1), 94–110.
- HOLLIS G.E. & STEVENSON A.C. (1997).** THE PHYSICAL BASIS OF THE LAKE MIKRI PRESPA SYSTEMS: GEOLOGY, CLIMATE, HYDROLOGY AND WATER QUALITY. *HYDROBIOLOGIA*, 351, 1–19.
- INSTITUTI I GJEOSHKENCAVE:** [HTTPS://WWW.GEO.EDU.AL](https://www.geo.edu.al)
- JORDANOVSKA B., KUNZ M.J., STAFILOV T. & WÜEST A. (2010).** TEMPORAL VARIABILITY IN PHYSIC-CHEMICAL PROPERTIES OF ST. NAUM KARTS SPRINGS FEEDING LAKE. *OHRID EKOL ZAŠT ŽIVOT SRED*, 13(1–2), 3–11.
- KAYANE I. (1997).** GLOBAL WARMING AND GROUNDWATER RESOURCES IN ARID LANDS. IN: “FRESHWATER RESOURCES IN ARID LANDS: UNU GLOBAL ENVIRONMENTAL FORUM V” (J. I. UITTO & J. SCHNEIDER, EDs.). *UNITED NATIONS UNIVERSITY PRESS*, TOKYO, 70–80.
- KIRI E. (2021).** HULUMTIM HIDRODINAMIK DHE HIDROKIMIK I SISTEMIT TË AKUIFERIT NDËRKUFITAR NË PELLGUN UJËMBLEDHËS PRESPË – OHËR. *TEZA E DOKTORATURES, UNIVERSITETI ARISTOTEL I SELANIKUT*, GREQI.
- KRSTIC S. (2012).** ENVIRONMENTAL CHANGES IN LAKES CATCHMENTS AS A TRIGGER FOR RAPID EUTROPHICATION—A PRESPA LAKE CASE STUDY. IN: “STUDIES ON ENVIRONMENTAL AND APPLIED GEOMORPHOLOGY”; *INTECHOPEN*, LONDON, UK, 63–118.
- LEIBUNDGUT CH., MALOSZEWSKI P. & KÜLLS CH. (2009).** TRACERS IN HYDROLOGY, WILEY – BLACKWELL, WEST SUSSEX, UK, p. 415.
- LELIEVELD J., HADJINICOLAOU P., KOSTOPOULOU E. ET AL. (2012).** CLIMATE CHANGE AND IMPACTS IN THE EASTERN MEDITERRANEAN AND THE MIDDLE EAST. *CLIMATIC CHANGE*, 114, 667–687.
- LENG M.J., WAGNER B., BOHEM A., PANAGIOTOPOULOS K., VANE C.H., SNELLING A., HAIDON C., WOODLY E., VOGEL H., ZANCHETA G. & BANESCHI I. (2013).** UNDERSTANDING PAST CLIMATIC AND HYDROLOGICAL VARIABILITY IN THE MEDITERRANEAN FROM LAKE PRESPA SEDIMENT ISOTOPE AND GEOCHEMICAL RECORD OVER THE LAST GLACIAL CYCLE. *QUATERNARY SCIENCE REVIEWS*, 66, 123–136.
- MATZINGER A., JORDANOSKI M., VELJANOSKA-SARAFILOSKA E., STURM M., MÜLLER B. & WÜEST A. (2006).** IS LAKE PRESPA JEOPARDIZING THE ECOSYSTEM OF ANCIENT LAKE OHRID? *HYDROBIOLOGIA*, 553, 89–109.
- MEÇE S. & ALIAJ SH. (2000).** GEOLOGY OF ALBANIA. *GEBRUDER BORNTAERGER*, BERLIN – STUTTGART, p. 246.
- MELO V. (2001).** POGRADEC (OHRID LAKE) AND PLOCA TECTONIC DOORSTEP (MORPHOSTRUCTURAL AND CINEMATIC ANALYSES). *ALBANIAN JOURNAL OF NATURAL & TECHNICAL SCIENCES*, 1, 123–136.
- MICEVSKI E. (2000).** GEOLOGICAL AND HYDRO-GEOLOGICAL CHARACTERISTICS OF THE OHRID - PRESPA REGION. *PROCEEDINGS OF THE INTERNATIONAL SYMPOSIUM “SUSTAINABLE DEVELOPMENT OF PRESPA REGION”*, OTESHEVO 23–25.06.2000, REPUBLIC OF MACEDONIA, p. 10–17.
- MICEVSKI E. (2002).** GEOLOGICAL AND HYDROGEOLOGICAL CHARACTERISTICS OF OHRID–PRESPA REGION. *MAKEDONSKI VODI*, IX, 21–29 (IN MACEDONIAN).
- POPOV V., ANOVSKA E., ARSOV M., AMATAJ S., KOLANECI M., STAMOS A., ARSOV L. & ANOVSKI T. (2009).** STUDY OF PRESPA – OHRID LAKE SYSTEM USING TRACER EXPERIMENTS AND THE LAKE’S WATER BALANCE. *WIT TRANSACTION AND ENGINEERING SCIENCES*, 125, 75–84.

- POPOVSKA C. & BONACCI O. (2007).** BASIC DATA ON THE HYDROLOGY OF LAKES OHRID AND PRESPIA. *HYDROLOGICAL PROCESSES*, 21(5), 658–664. DOI: 10.1002/hyp.6252.
- SANDSTRÖM K. (1995).** MODELING THE EFFECTS OF RAINFALL VARIABILITY ON GROUNDWATER RECHARGE IN SEMI-ARID TANZANIA. *HYDROLOGY RESEARCH (FORMER NORD HYDROL.)*, 26(4–5), 313–330.
- TANCO R. & KRUSE E. (2001).** PREDICTION OF SEASONAL WATER-TABLE FLUCTUATIONS IN LA PAMPA AND BUENOS AIRES, ARGENTINA. *HYDROGEOLOGY JOURNAL*, 9, 339–347.
- TAYLOR R.G., SCANLON B., DÖLL P., RODELL M., VAN BEEK R., WADA Y. ET AL. (2013).** GROUNDWATER AND CLIMATE CHANGE. *NATURE CLIMATE CHANGE*, 3, 322–329.
- TEMOVSKI M. (2016).** EVOLUTION OF KARST IN THE LOWER PART OF CRNA REKA RIVER BASIN. ISSN 2190-5061 (ELECTRONIC) AND ISBN 978-3-319-24547-8 (E-BOOK).
- VAN DER SCHRIEK T. & GIANNAKOPOULOS C. (2017).** DETERMINING THE CAUSES FOR THE DRAMATIC RECENT FALL OF LAKE PRESPIA (SOUTHWEST BALKANS). *HYDROLOGICAL SCIENCES JOURNAL*, 62(7), 1131–1148.
- VAN ENGELBURG J., HUETING R., RIJPKEMA S., TEULING A.J., UIJLENHOET R. & LUDWIG F. (2018).** IMPACT OF CHANGES IN GROUNDWATER EXTRACTIONS AND CLIMATE CHANGE ON GROUNDWATER-DEPENDENT ECOSYSTEMS IN A COMPLEX HYDROGEOLOGICAL SETTING. *WATER RESOURCES MANAGEMENT*, 32, 259–272.
- VRANAI A., SHALLO M. & XHOMO A. (1997).** GEOLOGY OF ALBANIA. UNIVERSITY BOOK, TIRANA, P. 145–208.
- XHOMO A., KODRA A., XHAFI Z. & SHALLO M. (2002).** GEOLOGICAL MAP OF ALBANIA, SCALE 1:200 000. *ALBANIAN GEOLOGICAL SURVEY*, TIRANA. P. 410 (IN ALBANIAN).
- WESTERLING A.L., HIDALGO H.G., CAYAN D.R. & SWETNAM T.W. (2006).** WARMING AND EARLIER SPRING INCREASE WESTERN U.S. WILDFIRE ACTIVITY. *SCIENCE*, 313, 940–943.

THE IMPACT OF CLIMATE CHANGE ON THE DYNAMICS OF HYDROCHEMICAL PROCESSES OF GROUNDWATER IN THE OHRID – PRESIPA REGION, SOUTHEASTERN ALBANIA

BRISILDA STAFA¹ & ARJAN BEQIRAJ^{2*}

¹Institute of GeoSciences (UPT), Don Bosko Nr. 60, Tirana, Albania.

²Polytechnic University of Tirana, Faculty of Geology and Mining, Blvd. Dëshmorët e Kombit Nr. 4, Tirana, Albania.

*Corresponding author: arjan.beqiraj@fgjm.edu.al

(Manuscript submitted in August 2025; accepted for publication in November 2025)

Abstract. *This paper aims to evaluate the effects of climate changes on the hydrochemical processes and groundwater regime of the Ohrid – Prespa aquatic ecosystem through the study of the physico – chemical characteristics of surface and groundwater. The Mali i Thatë – Galiçica mountain range, composed of Triassic – Jurassic limestone, contains karst voids that enable the movement of groundwater toward Lake Ohrid and its discharge in the form of springs. The hydrochemical characteristics classify the waters of the Ohrid – Prespa ecosystem into the Ca-HCO₃ and Ca-Mg-HCO₃ types, having closer relations with the karst and Lake Great Prespa, respectively. Waters of the Ca-HCO₃ type are characterised by lower Total Dissolved Solid (TDS) values (TDS < 300 mg/l), relative to the Ca-Mg-HCO₃ waters which have TDS values (TDS > 300 mg/l). The quantitative assessment of the the karst and Lake Great Prespa contribution to water of the springs that discharge along the shore of Lake Ohrid, carried out by using the mass balance equation of mixed water fractions and the chemical balance of chloride content in the water, indicated that, during the spring season, the Elshan, Kufi, and Biljana springs are mostly recharged (> 50%) by the karst water, whereas in the autumn, the Tushemisht, Gurras, and St. Naum springs are also recharged by more than 50% by the karst water. This finding, confirmed by the significant decrease in silica content in the sampled spring waters during autumn, indicates that as the water level in Lake Great Prespa declines, the specific contribution of karst to the springs discharge and Lake Ohrid balance, increases.*

Keywords: *Karst springs, groundwater, climate change, lake, Lake Great Prespa, Ohrid.*

INTRODUCTION

Groundwater constitutes a vital resource for sustaining life on Earth, as it represents the largest reservoir of the fresh liquid water on the planet (Fetter 2001). Van Engelenburg et al. (2018) highlighted the influence of climate change on groundwater levels, whereas Taylor et al. (2013) demonstrated that global climate change has the potential to affect both the quantity and quality of groundwater resources. A significant portion of these resources is represented by karst groundwater,

which is associated with soluble rocks such as limestone and evaporite. Karst formations cover approximately 24% of Albania's territory, of which 6,500 km² consist of Triassic – Jurassic – Cretaceous and Paleocene – Eocene carbonate rocks, while 260 km² are composed of Permo – Triassic evaporites (Eftimi 2019).

Lakes Great Prespa and Ohrid, located on the border between Southeastern Albania, North Macedonia and Greece, form an hydrologically connected

system which is under continuous pressure of the climate changes. Numerous studies have investigated the impacts of these changes, focusing on the decline in water level in Lake Great Prespa, the hydraulic connectivity between Lakes Great Prespa and Ohrid, the contribution of Great Prespa water to the springs discharging along the shores of Lake Ohrid, and the broader implications of climate change for the hydrology of the Prespa – Ohrid aquatic system (Popovska & Bonacci 2007; Leng et al. 2023; Schriek & Giannakopoulos 2017).

Water losses from Lake Great Prespa are primarily attributed to evaporation from the lake surface and subsurface drainage through karst conduits toward Lake Ohrid (Eftimi 2019). The hypothesis of subsurface outflow from Great Prespa to Lake Ohrid was first proposed by Cvijić (1906), and has more recently been confirmed through the use of natural tracers (Eftimi et al. 2021) and artificial tracers (Popov et al. 2009). The present study, based on a representative sampling campaign conducted across two seasons (spring and autumn), aims to highlight the origin of spring waters, identify the mechanisms governing groundwater recharge, assess the influence of climate change on the hydrological cycle, and evaluate potential risks to the sustainability of future water resources.

GEOLOGICAL SETTING

Study Area

The Ohrid – Prespa region represents the oldest inland water basin in Europe and among the oldest in the

world, dating back to the Pliocene, approximately 3 – 5 million years ago (Krstić 2012). The study area includes the karst system of the transboundary lakes—Small Prespa, Great Prespa, and Ohrid (Krstić 2012)—which together form a unified hydraulic system (Eftimi 2019).

Great Prespa and Small Prespa Lakes occupy the deepest areas of an enclosed mountainous basin and both have not any natural surface outflow. The hydraulic connection between them is realised only through subsurface flow, whereby water from Great Prespa Lake (approximately 849 m a.s.l.) drains westward toward Lake Ohrid, which lies about 150 meters lower (Krstić 2012). Small Prespa and Great Prespa are separated by a neck composed of alluvial deposits. In 1969, a dam was constructed by the Greek authorities to regulate the water flow from Small Prespa to Great Prespa. The surface areas of Small Prespa, Great Prespa, and Lake Ohrid are 47.4 km², 274 km², and 348 km², respectively, with maximum depths of 8 m, 54 m, and 288 m (Eftimi et al. 1985).

The Ohrid – Prespa region comprises geological formations that span from the Paleozoic metamorphic rocks to Neogene and Quaternary sedimentary formations (Micevski 2000). The Mali i Thatë – Galičica mountain range is entirely composed of massive Upper Triassic – Lower Jurassic limestones, with minor occurrences of Upper Cretaceous limestones. According to Vranaj et al. (1997) and Xhomo et al. (2002), the total thickness of the Triassic – Jurassic carbonate deposits reaches approximately 1,000 – 1,200 m. Small outcrops of Eocene

limestone conglomerates occur mainly in the southern part of the area (Eftimi & Zoto 1997). The relief of Mount Galičica is characterized primarily by well-developed karst features, including holes and flat karst plains (Micevski 2000). The floor of Lake Prespa is largely covered by Pliocene deposits consisting of clays, sandstones, and conglomerates, which are also exposed along parts of the lakeshore (Eftimi & Zoto 1997).

The study area belongs to the internal zone of the Alpine orogenic belt, which underwent significant tectonic activity during the Pliocene – Quaternary interval (Meçe & Aliaj 2000; Melo 2001; Temovski 2016). These tectonic processes, including strong and progressive uplift, led to the formation of the Mali i Thatë – Galičica horst, whereas on both sides by, graben structures are formed, represented by the Prespa Basin to the east, and the Ohrid Basin together with the Korça Plain to the west.

The Ohrid Basin lies at the structural boundary between the Mirdita Ophiolite Zone and the Korabi Zone, a contact clearly observed south of the Lin Peninsula and along the western shoreline of the lake. In this region, the Korabi Zone is composed mainly of Paleozoic metamorphic and magmatic rocks, forming an anticlinal structure in the area situated between the Prespa and Ohrid lakes (Hoffmann et al. 2012).

Hydrogeology

In southeastern Albania, along the border with North Macedonia and Greece, Lakes Prespa and Ohrid form a common hydraulic system (Eftimi

2019). The outflow from Great Prespa Lake is primarily governed by karstic subsurface infiltration toward Lake Ohrid (Eftimi 2019) and, to a lesser extent, by evaporation from the lake surface and water abstraction for domestic and agricultural use by the local communities (Beqiraj 2018). Numerous karst springs emerge along the western slopes of the Galičica/Mali i Thatë range and discharge directly into Lake Ohrid. Springs occurring at elevations higher than the water level of Great Prespa Lake are entirely recharged by karst groundwater derived from direct precipitation on the mountain tops.

Tracer studies have demonstrated that the Tushemisht spring (2.5 m³/s) in Albania and the Saint Naum spring (7.5 m³/s) in North Macedonia are partially supplied by Great Prespa Lake (Matzinger et al. 2006). As early as the beginning of the 20th century, the geographer Jovan Cvijić provided a detailed description of karst phenomena in the Prespa – Ohrid region and formulated the hypothesis that the Saint Naum and Tushemisht springs are recharged by Lake Prespa (Cvijić 1906).

The most significant karst feature in the area is the Zaver swallow hole, located on the western shore of Great Prespa Lake between the villages of Goricë e Vogël and Gollomboç (in Albanian territory). At this location, lake water infiltrates underground and reappears in the major karst springs along the shore of Lake Ohrid (Eftimi et al. 1985; Eftimi 2019).

Hydrology

NDËRTIMI GJEOLGJIK

Formacionet gjeologjike më të vjetra në njësinë e Lisen – Spitenit (Fig. 1)

fillojnë me formacionin vullkano – sedimentar të Triasikut të Mesëm, dhe vazhdon me formacionin karbonatik me moshë nga Triasiku deri në Paleocen dhe më sipër prerja mbyllet me formacionin flishor të Eocenit (Xhomo et al. 2002). Të dhënat mbi stratigrafinë e njësisë së Lisen – Spitenit tregojnë për mjedise të ndryshme sedimentimi, të ujërave të cekët (neritike) dhe ujërave të thellë (pelagjike). Një rol të rëndësishëm në stilin tektonik të njësisë së Lisen – Spitenit kanë luajtur thyerjet e vjetra të riftëzimit. Këto thyerje janë të lidhura ngushtë me proceset e riftëzimit të brezit strukturor Albanide dhe krijimin e strukturave tektonike të tipit horst dhe grabene. Mendimi i shprehur në këtë studim është se kjo njësi është pjesë e zonës së Krastë – Cukalit (zona e Pindit).

¹ FGJM, Tiranë
ndhurata@yahoo.it

të Jurasikut të Poshtëm – i Mesëm. Mbi këto depozitime kemi depozitime të katit Toarian. Depozitimet e katit Toarian përfaqësohen kryesisht nga gëlqerorë nyjorë të pasur me amonite deri shkëmbformuese me një trashësi 3 – 4 m me ngjyrë të kuqurremtë tip wackestone me radiolare, dhe filamente bivalvoresh pelagjike, që është një facie tipike për të gjithë Mesdheun që ndryshe quhet “Ammonitico rosso” (Dodona 1973; Xhomo et al. 1975; Fig. 2).

Mbi horizontin “Ammonitico rosso” kemi gëlqerorë të tipit mudstone me ngjyre roze të ndërthurur me ndërshtresa dhe thjerza silicoresh (Fig. 2). Këto depozitime i përkasin Jurasikut të mesëm dhe vendosen në mënyrë suksesive mbi depozitimet e facies “Ammonitico rosso” kurse në shtrirje në anën veriore të rajonit të studimit vendosen me onlap mbi depozitimet e Trasiikut të Sipërm dhe Jurasikut të Poshtëm. Kjo tregon se në kohën e depozitimit të tyre baseni nuk ka qënë uniform por i ndërtuar me horste dhe grabene.

Mbi depozitimet e Jurasikut të Mesëm vendosen depozitimet e Jurasikut të Sipërm, këto depozitime si duken edhe në figuren 2, përfaqësohen kryesisht nga shkëmbinj silicorë me ndërshtresa të rralla gëlqerorësh të tipit wackestone, radiolaritike, me ngjyre të kuqe, mjaft të silicizuar. Këto depozitime si dhe ato të nënshtrira

vendosen me onlap mbi depozitimet me të vjetra të Triasik – Jurasikut të Poshtëm. Kurse në pjesët e grabenit vendosen në mënyrë suksesive mbi depozitimet e Jurasikut të Mesëm. Trashësia e tyre është e rendit 18 m.

Në tavanin e radiolariteve takohen specie të *Saccocoma* sp. që dëshmojnë me tepër për një moshë të katit Titonian (Dodona 1973). Mbi pakon e silicoreve radiolaritike vendoset pakua e gëlqerorëve të tipit mudstone dhe wackestone ku janë takuar kalpionelide që tregojnë një moshe Titonianit i sipërm – Beriasianit i poshtëm, Biozona B me *Calpionella elliptica*. Në vijim të prerjes këta gëlqerorë i përkasin moshës së Kretakut i Poshtëm (Xhomo 1966). Depozitimet kretake të njësisë së Lisen – Spitenit përfaqësohen nga gëlqerorë pelagjike në facies së kondensuar, shoqëruar me pushime në sedimentim, me trashësi shumë të vogël (23 m). Zakonisht ata vendosen normalisht ose me pushim në sedimentim mbi radiolaritet e Jurasikut të Sipërm (Xhomo 1966). Në disa raste ato vendosen direkt mbi gëlqerorët e Triasikut të Sipërm dhe përfaqësohen nga depozitime turbitidike konglobrekçore. Kurse në zonën e Spitenit ndërtohet nga gëlqerorë të tipit wackestone me ngjyre hiri dhe roze, gëlqerorë mergëlore me thjerrza e konkrecione silicoresh, sidomos në pjesën e poshtme të prerjes.




Figura 2. Pamje të depozitimeve pjesë e këtij studimit.

Tektonika e zonës së studiuar

Njësia e Lisen – Spitenit (Fig. 3) përfaqëson një ngritje nënujore në zonën e Krastës – Cukalit që në krahasim me pjesën tjetër të zonës tektonike janë vërejtur sedimente pelagjike (të detit të thellë) me trashësi shumë të reduktuara, mungesë e materialit turbiditik dhe prania e pushimeve të shumta nënujore (Xhomo et al. 2002).

Në rajonin Gurit i Zi – Vau i Dejës, njësia e Lisen – Spitenit mbihipën mbi fliшет e nënzonës së Krastës me moshë Kretak i Sipërm – Eocen, kurse në lindje të saj ajo mbulohet nga ofiolitet e brezit perëndimor të zonës Mirdita me moshë të Jurasikut të Mesëm dhe të Sipërm. Në sektorin Manati – Spitenit kjo njësi në perëndim kufizohet tektonikisht me fliшин Eocenik të Krastës, kurse në lindje mbihipet nga

nënzona e Krastës, duke dalë në Manati në trajtën e një dritare tektonike. Në përgjithësi në të gjithë daljet e saj paraqitet në trajtën e monoklinaleve me rënie lindore ($35^{\circ} - 40^{\circ}$) (Xhomo et al. 2002), të cilët janë të fragmentuar në blloqe nga shkëputjet tektonike si gjatë shtrishmërisë së tyre ashtu dhe tërthorë saj. Në shtrirje të strukturës së Spitenit janë vërejtur disa thyerje tektonike që janë të kohës së riftingut bazuar në të dhënat e marra nga vërtetimet fushore (Fig. 2). Në këtë rajon vërehet fenomeni i riftëzimit ku vërehen një sërë strukturash komplekse kryesisht horste dhe grabene ku depozitimet më të reja vendosen me onlap mbi ato më të vjetra. Ky fenomen është vërejtur edhe në zonën Jonike (Ndreko & Nazaj 2019). Siç dihet buzina e Albanideve ose pjesa lindore e mikropllakës së Adrias (Fig. 3) në Jurasikun e Poshtëm dhe të Mesëm ka arritur maksimumin e hapjes dhe në këtë kohë janë

individualizuar zonat tektonike që në dokumentojmë dhe sot.

Në fund të Jurasikut të Poshtëm dhe të Mesëm në njësinë e Lisenit – Spitenit ngelen të disa thyerje tektonike ku vërehen disa horste dhe grabene, ku horste shërbejnë si pjesë të ngritura kurse grabenet si basene. Në pjesët e ngritura pothuajse nuk depozitohen kurse në grabene kishim depozitim. Kjo duket shumë qartë në këtë zonë ku depozitimet e katit Toarian të facies “Ammonitico rosso” vendosen me onlap mbi depozitime me të vjetra të Triasikut. Një situatë e ngjashme është dhe për depozitimet e Jurasikut të Mesëm, pakua e gëlqerorëve dhe pakua e silicoreve (Fig. 2). Kjo situatë ka vazhduar deri në Kretakun e Poshtëm ku gëlqerorët maidstone me tintinide vendosen me onlap mbi depozitimet më të vjetra të Triasikut mbas edhe të depozitimeve të Jurasikut të Poshtëm dhe të Mesëm (Fig. 4).




Figura 3. Skema e buzinës së Albanideve në fund të Jurasikut të Poshtëm dhe të Mesëm (sipas Ndreko 2021).




Figura 4. a) Marrëdhëniet midis strukturave gjeologjike para riftëzimit Triasik – Jurasik i Poshtëm dhe i Mesëm dhe pas riftëzimit kati Toarian deri në Kretak; **b)** Skicë gjeologjike që tregon marrëdhëniet midis depozitimeve të para riftëzimit Triasik – Jurasik i Poshtëm dhe pas riftëzimit kati Toarian deri në Kretak që vendosen me onlap mbi “horstet” e para riftëzimit.

PËRFUNDIME

Njësia e Lisen – Spitenit bën pjesë në zonën tektonike të Krasta – Cukalit dhe ka ndërtim gjeologjik të ndërlikuar ku takohen dy litofacie që i përkasin dy mjediseve depozicionale të ndryshme. Depozitimet te ujerave te cekëta përfaqësohen nga gëlqerorë

shtresëtrashë të pasura me alge gëlqerorë dhe megalodonte ndërsa depozitimet pelagjike përfaqësohen nga gëlqerorë me radiolare dhe gëlqerore të pasur me ammonite në “Ammonitico rosso”.

Thyerjet tektonike të kohës së riftëzimit të Jurasikut të Poshtëm dhe të Mesëm

kanë luajtur një rol të rëndësishëm në formimin e strukturave gjeologjike të tipit të horsteve dhe grabeneve në njësinë e Lisen – Spitenit si dhe kanë kontrolluar sedimentimin e litofacieve të ndryshme. Ndryshimet në sedimentim vërehen shumë qartë, ku depozitimet e katit Toarian të facies “Ammonitico rosso” dhe depozitimet e Jurasikut të Mesëm dhe të Sipërm

ndoshta edhe të Kretakut të Poshtëm vendosen me onlap mbi depozitime me të vjetra të Triasikut të Sipërm dhe depozitimeve të Jurasikut të Poshtëm dhe të Mesëm.

Falënderime. Duam të falënderojmë ekspertit të jashtëm për sugjerimet e bera lidhur me korigjimit e këtij artikullit.

REFERENCA

DERCOURT J. (1968). SUR L'ACCIDENT DE SCUTARI-PEC, LA SIGNIFICATION PALÉOGÉOGRAPHIQUE DE QUELQUES SÉRIES CONDENSÉES EN ALBANIE SEPTENTRIONALE. *ANN. SOC. GÉOL. NORD*, VOL 88, 3, 109-117.

DODONA E. (1973). GJEOLGJIA MIKROFAUNA, MIKROFACIET DHE PALEOGJEOGRAFIA E PRERJEVE TE LISNES DHE SPITENIT. *PËRMBLEDHJE STUDIMESH*, 101-139.

MEÇO S. (1999). CONODONT BIOSTRATIGRAPHY OF TRIASIC PELAGIC STRATA ALBANIA. *REVISTA ITALIANA DI PALEONTOLOGIA E STRATIGRAFIA*, VOL 105, 251-266.

MEÇO S. (1999). STUDIM I DETAJUAR I DEPOZITIMEVE TE PERMIANIT TE SIPERM DHE TRIASIKUT TË POSHTËM E TË MESËM NË ZONËN E ALPEVE SHQIPTARE DHE ATË TË CUKALIT. *FONDI I F.G.J.M TIRANË*.

NDREKO DH. & NAZAJ SH. (2019). THE DYNAMIC ROLE OF TECTONIC FAULTS IN GEOLOGICAL EVOLUTION OF THE REGION IN NORTH - WEST ALBANIA. *JOURNAL OF INTERNATIONAL ENVIRONMENTAL APPLICATION AND SCIENCE*, 54 - 61.

NDREKO DH. (2021). MODELI GJEOLGO – TEKTONIK DHE FLUIDMBAJTJA E RAJONIT KRESHPAN – VERBAS NËN DITËN E TË DHËNAVE SIZMIKE 3D. F.G.J.M. TIRANË (DIZERTACION)

XHOMO A. (1966). TË DHENA MBI DEPOZITIMET MESOZOIKE TË SPITENIT DHE LISNES. *PËRMBLEDHJE STUDIMESH*, 113-126.

XHOMO A., KODRA A., XHAFA Z. & SHALLO M. (2002). GEOLOGJIA E SHQIPËRISË – TEKST SHPJEGUES I HARTËS 1:200 000 (ALBANIAN GEOLOGY - EXPLANATORY TEXT OF MAP 1: 200 000). *MINISTRIA E INDUSTRIJË DHE ENERJITIKËS, MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS, SHËRBI MI GJEOLGJIK SHQIPTAR, ALBPETROL, UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS, TIRANA*, P. 435.

XHOMO A., PEZA L. & PIRDENI A. (1975). NJË KONTRIBUT PËR NJOHJEN E STRATIGRAFISË SË ZONËS SË KRASË - CUKALIT (NËNZONA E CUKALIT). *PËRMBLEDHJE STUDIMESH*, 5-36.

SOME DATA ON THE RIFT FAULTS IN THE LISEN – SPITEN UNIT

DHURATA NDREKO^{1*}, ARJOL LULE¹ & SHAQIR NAZAJ¹

¹Polytechnic University of Tirana, Faculty of Geology and Mining, Dëshmorët
e Kombit Blvd. 4, Tirana, Albania.

*Corresponding author: ndhurata@yahoo.it

(Manuscript submitted in May2025; accepted for publication in November 2025).

Abstract. *The Lisen – Spiten unit is part of the Krasta-Cukali tectonic zone (External Albanides) the lithological formations ranging in age from the Triassic to the Eocene. This article will provide some data on the rift faults in the Lisen – Spiten unit. Evaluating these rift faults makes it possible to determine the geologic-tectonic evolution of the region. In the Lisen – Spiten unit, the rift-related faults formed during the Lower and Middle Jurassic. These faults created horst and graben structures, which are typical for rifting processes. This study offers a deeper understanding of the impact of tectonic rifting in the Lisen – Spiten unit, and constitutes an important contribution to the geotectonic and stratigraphic analyses of this region.*

Keywords: *Lisen – Spiten, tectonic faults, rifting, Albania.*

INTRODUCTION

The study area is located to the northeast of the Mati River, east of the villages of Zejmen, Spiten, and Manati. Lisen – Spiten unit is part of the Krasta – Cukali tectonic zone (External Albanides) and has a complicated geological structure, formed as a result of the geologic – tectonic development during different geologic periods. Some authors have various opinions regarding the Lisen – Spiten unit. Dercourt (1968) considers this unit as a continuation of the ridge of the Albanian Alps tectonic zone, whereas Xhomo et al. (2002) regard it as an underwater uplift within the Krasta – Cukali tectonic zone.

GEOLOGICAL SETTING

The oldest geological formations in the Lisen – Spiten unit (Fig. 1)

belong to the Middle Triassic volcano – sedimentary deposits, being overlain by the carbonate deposits ranging from Triassic to Paleocene. The succession is ending with an Eocene flysch sequence (Xhomo et al. 2002). Data on the stratigraphy of the Lisen – Spiten unit indicate the presence of different sedimentary palaeoenvironments, from shallow- to deep water areas. The rift faults have played an important role in the tectonic evolution of the Lisen – Spiten unit. These faults are closely related to the rifting processes of the Albanides' structural belt and the existence of various tectonic horst and graben structures. It is believed that this unit is part of the Krasta – Cukali Zone (the Pindos zone in Greece).

¹ FGJM, Tiranë
ndhurata@yahoo.it




Figure 1. Geological map of the studied area (Xhomo et al. 2002).

METHODOLOGY

This study combines the data from the existing literature with new field observations of the investigated area. During the field works, lithological observations of the studied deposits and evaluation of the relationships between strata of various ages belonging to this unit were done.

RESULTS AND DISCUSSIONS

The geological structure of the Lisen – Spiten unit comprises a variety of formations represented by two depositional lithofacies, represented by shallow- and deep marine palaeoenvironments (Xhomo et al. 2002). In the study area, the oldest deposits belong to Upper Triassic (Meço 1999). Lithologically, these formations comprise thick – bedded to massive limestones rich in calcareous algae and bivalves, mainly represented by megalodonts. The presence of

limestones sediments indicates a shallow shelf palaeoenvironment (Dodona 1973; Meço 1999; Fig. 2). Successively overlying these deposits are the Lower – Middle Jurassic limestones.

The section is represented by thick – bedded wackestone, 30 – 35 m thick, gray in color, which contains crinoids, lagenides and ostracods (Xhomo et al. 1975). In the upper part, the limestones are thin – bedded, gray and pink in color, containing ammonites (Fig. 2). up to 15 – 20 cm in diameter, similar to those observed at the top of the limestone unit.

The age of this depositional level, based on the presence of *Involutina liassica* and *Vidalina martana* is Lower – Middle Jurassic. Above these deposits overlie the Toarcian sediments. These are represented mainly by nodular reddish limestones rich in ammonites (locally so abundant as to

be rock – forming), with a thickness of 3 – 4 m, of wackestone type with radiolarians and pelagic bivalves. These palaeoenvironments are typical for the entire Mediterranean and are known as the “Ammonitico rosso” (Dodona 1973; Xhomo et al. 1975; Fig. 2).

Above the “Ammonitico rosso” horizon, there are pink mudstone deposits interbedded with siliceous layers and lenses (Fig. 2). These formations belong to the Middle Jurassic and lie successively above the “Ammonitico rosso” horizon. However, in the northern part of the studied area, they overlie on the Upper Triassic and Lower Jurassic formation. This indicates that at the time of their deposition the basin was not uniform but was formed of horst and graben structures.

Above the Middle Jurassic deposits lie the Upper Jurassic formation. As seen in figure 2, these are represented mainly by radiolarites (siliceous, radiolarian rocks) with rare interlayers of wackestone, red in color and highly silicified. This formation, as well as those beneath them, onlap onto the older Triassic – Lower Jurassic deposits. In the graben areas, however, they lie in regular succession above the Middle Jurassic

formation. Their thickness is around 18 m. At the top of the radiolaritic sequence were identified species belonging to *Saccocoma* sp., which indicate a Tithonian age (Dodona 1973). Above the radiolaritic siliceous sequence lies a package of mudstone and wackestone limestones in which calpionellids have been found, indicating an upper Tithonian – lower Berriasian (Biozone B with *Calpionella elliptica*). Further along the section, these limestones belong to the Lower Cretaceous (Xhomo 1966).

The Cretaceous sequence of the Lisen – Spiten unit is represented by pelagic limestones in condensed facies, accompanied by numerous hiatuses in sedimentation, and with very small thickness of around 23 m. They usually lie either conformably or with a hiatus on top of the Upper Jurassic radiolarites (Xhomo 1966). In some cases, they lie directly on the Upper Triassic limestones, and are represented by turbiditic conglomerate deposits. In the Spiten area, the Lower Cretaceous sequence consists of grayish and pink wackestone-type limestones, and marly limestones with siliceous lenses and concretions, especially in the lower part of the section.




Figure 3. View of the deposits part of the study.

Tectonics of the studied area

The Lisen – Spiten unit represents a submerged uplift within the Krasta – Cukali zone. In comparison with the other part of this tectonic zone, the deep – marine sediments have reduced thickness and less turbiditic material (Xhomo et al. 2002). In the Guri i Zi – Vau i Dejës region, the Lisen – Spiten unit overthrusts the

flysch of the Krasta subzone (Upper Cretaceous – Eocene), whereas to the east, it is overlain by the ophiolites of the western belt of the Mirdita Zone (Middle – Upper Jurassic age).

In the Manati – Spiten sector, this unit is tectonically bounded to the west by the Eocene flysch of Krasta, and to the east it’s overthrusts by the Krasta subzone, emerging in Manati

area in the form of a tectonic window. In general, in all its exposure, the unit appears as a series of monoclines with eastward dips of about 35°–40° (Xhomo et al. 2002), which are fragmented into blocks by transverse tectonic faults.

Within the Spiten structure, based on field observation data, several tectonic faults of rifting nature have been observed, (Fig. 2). In this region, the phenomenon of rifting is evident, with a number of complex structures, mainly horsts and grabens, where younger deposits onlap older ones. This phenomenon has also been observed in the Ionian zone (Ndreko & Nazaj 2019).

As acknowledged, the Albanides margin (the eastern part of the Adria microplate; Fig. 3) reached its maximum extension in the Early and Middle Jurassic, and at that time, the tectonic zones that are documented

within this study became established.

At the end of the Lower – Middle Jurassic in the Lisen – Spiten unit, there are some tectonic faults where some horsts and grabens are observed, where horsts serve as elevated parts and grabens as basins. In the elevated parts there was almost no deposition, while in the grabens we had sedimentation. This is very clear in the investigated area, where the deposits of the Toarcian age belonging to the “Ammonitico rosso” facies, overlie the older deposits of the Triassic age. A similar situation is also for the deposits of the Middle Jurassic, the limestone’s succession and the radiolaritic package (Fig. 2). This situation has continued until the Early Cretaceous where limestones with tintinnids deposited (they onlap) on the older Triassic deposits and perhaps also the deposits of the Lower – Middle Jurassic.




Figure 3. Scheme of the Albanides at the end of the Early – Middle Jurassic (after Ndreko 2021).




Figure 4. a) Relationships between geological structures before rifting (Triassic – Lower/Middle Jurassic) and after rifting (Toarcian to Cretaceous); **b)** Geological sketch showing the relationships between pre-rifting deposits (Triassic – Lower Jurassic) and post-rifting deposits (Toarcian to Cretaceous) that onlap the pre-rifting horsts

CONCLUSIONS

The Lisen – Spiten unit is part of the Krasta-Cukali tectonic zone and has a complicated geological structure, where two lithofacies are present corresponding to two different depositional environments. The

shallow water deposits are represented by thick – bedded limestones rich in calcareous algae and megalodonts, whereas the pelagic deposits are represented by radiolaritic limestones and ammonite – rich limestones belonging to the “Ammonitico rosso”

facies. The tectonic faults formed during the Lower and Middle Jurassic rifting period played an important role in the formation of horst- and graben type geological structures in the Lisen – Spiten unit, and they controlled the sedimentation of the various deposits and the existence of various lithofacies. Changes in sedimentation are clearly observed in the region. The deposits of the Toarcian stage

belonging to the “Ammonitico rosso” facies, as well as the Middle and Upper Jurassic deposits (and possibly those of the Lower Cretaceous), onlap onto older deposits of the Upper Triassic and Lower – Middle Jurassic.

Acknowledgments: We thank the external reviewer for the suggestions made for the improvement of this manuscript.

REFERENCES

- DERCOURT J. (1968).** SUR L'ACCIDENT DE SCUTARI-PEC, LA SIGNIFICATION PALÉOGÉOGRAPHIQUE DE QUELQUES SÉRIES CONDENSÉES EN ALBANIE SEPTENTRIONALE. *ANN. SOC. GÉOL. NORD*, VOL 88, 3, 109-117.
- DODONA E. (1973).** GEOLOGY, MICROFAUNA, MICROFACIES AND PALAEOGEOGRAPHY OF LISEN AND SPOTEN TRANSECTS. *PËRMBLEDHJE STUDIMESH*, 101-139 (IN ALBANIAN).
- MEÇO S. (1999).** CONODONT BIOSTRATIGRAPHY OF TRIASSIC PELAGIC STRATA ALBANIA. *REVISTA ITALIANA DI PALEONTOLOGIA E STRATIGRAFIA*, VOL 105, 251-266 (IN ALBANIAN).
- MEÇO S. (1999).** DETAILED STUDY OF THE UPPER PERMIAN TO LOWER – MIDDLE TRIASSIC DEPOSITS IN ALBANIAN ALPS AND CUKALI AREAS. *FONDI I F.GJ.M TIRANË* (IN ALBANIAN).
- NDREKO DH. & NAZAJ SH. (2019).** THE DYNAMIC ROLE OF TECTONIC FAULTS IN GEOLOGICAL EVOLUTION OF THE REGION IN NORTH - WEST ALBANIA. *JOURNAL OF INTERNATIONAL ENVIRONMENTAL APPLICATION AND SCIENCE*, 54 - 61.
- NDREKO DH. (2021).** GEOLOGICAL – TECTONICAL MODEL AND FLUID RETENTION IN THE KRESHPAN – VERBAS AREA ACCORDING TO 3D SEISMIC MODELLING. *F.GJ.M. TIRANË* (PHD THESIS) (IN ALBANIAN).
- XHOMO A. (1966).** DATA ON MESSOZOIC DEPOSITS OF THE SPITENI AND LISEN AREA. *PËRMBLEDHJE STUDIMESH*, 113-126 (IN ALBANIAN).
- XHOMO A., KODRA A., XHafa Z. & SHALLO M. (2002).** ALBANIAN GEOLOGY – EXPLANATORY HANDBOOK OF ALBANIAN TERRITORY MAP 1:200 000 *MINISTRIA E INDUSTRIË DHE ENERGJITIKËS, MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS, SHËRBIMI GJEOLGJIK SHQIPTAR, ALBPETROL, UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS, TIRANA*, P. 435 (IN ALBANIAN).
- XHOMO A., PEZA L. & PIRDENI A. (1975).** A CONTRIBUTION TO THE STRATIGRAPHY OF THE KRATA - CUKALIT ZONE (CUKALI SUBZONE). *PËRMBLEDHJE STUDIMESH*, 5-36 (IN ALBANIAN).

BIOSTRATIGRAFIA E NANOFOSILEVE GËLQERORE NGA FORMACIONI “MERGELET ME CHAMA” NË MORAVË SHQIPËRI (BASENI SHQIPTARO – THESSALIAN)

MĂDĂLINA – ELENA KALLANXHI¹*

¹Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Rruga Zef Serembe, Tiranë, Albania.

*Autori korrespondent: madalina_kallanxhi@yahoo.com

(Dorëshkrim i dorëzuar në nëntor 2025; i pranuar për botim në nëntor 2025)

Abstrakt. Ky artikull fokusohet në studimin biostratigrafik të nanofosileve gëlqerore nga një prerje pjesë e Formacioni “Mergelet me Chama” (Baseni Shqiptaro – Thessalian). Me qëllim realizimin i këtij studimit janë mbledhur 56 kampionë të cilët janë përgatitur sipas metodave standarde dhe janë analizuar në mikroskop për përmbajtjen e nanofosileve gëlqerore. Ky punim nxjerr në pah rezultate të rëndësishme biostratigrafike përsa i përket bashkëshoqërimeve të nanofosileve gëlqerore, pranisë së specieve treguese të moshës për intervalin Rupelian – Hatian dhe përmirëson kuadrin e përgjithshëm biostratigrafik duke ofruar të dhëna të reja lidhur me zonën e studiuar. Duke u bazuar në praninë e specieve treguese, depozitimet e studiar janë përfshirë në zonat NP24/CP19a të skemave standarde të nanofosileve gëlqerore, zona të cilat u përkasin një interval kohor Rupelian i vonshëm – Hatian i hershëm.

Fjalë kyçe: biostratigrafi, Oligocen, nanofosileve gëlqerore, mali Morava, Baseni Shqiptaro – Thessalian.

HYRJA

Nanofosilet gëlqerore kanë një rëndësi të veçantë në studime biostratigrafike, për përcaktimin e moshës së sedimenteve, dhe shtrihen në një hapësirë kohore nga Triasiku i vonshëm deri në kohët e sotme. Ky grup përfshin mikrofosilet e përbëra prej karbonatit të kalciumit, me madhësi më të vogël se 63 µm (mikron). Ky grup shfaq një shpërndarje biogeografike më e larmishme në gjerësitë e ulëta, ndërsa mungon mbi 70° në gjerësitë më të lartë.

Qëllimi i këtij artikulli ka qënë studimi biostratigrafik i nanofosileve gëlqerore nga një profil me moshë oligocenike, pjesë e Formacionit “Mergelet me Chama”, identifikimi i specieve treguese, analizimi i bashkëshoqërimeve nga kampionët

e marrë dhe përcaktimi i biozonave moshore sipas skemave biostratigrafike ndërkombëtare.

Studimet më të fundit mbi nanofosilet gëlqerore nga Shqipëria janë bërë në depozitimet molasike të Basenit Shqiptaro – Thessaliane në rrethinat e qytetit të Korçës (fshatrat Mborja, Drenova, Mirasi, Dardha) dhe kapin një interval nga Rupeliani i mesëm deri në Miocenin i mesëm (Kallanxhi et al. 2016; Kallanxhi 2020; Kallanxhi & Young 2020; Kallanxhi 2023). Moshë e depozitimeve Oligocene të zonës së Moravës është përcaktuar në shumicën e rasteve me anë të makrofosileve dhe foraminiferave. Studime krahasuese të bashkëshoqërimeve makrofosileve të depozitimeve molasike të Basenit Shqiptaro – Thessalian me ato të

Basenit Mezohelenike (Harzhauser 2004; Pashko 2018), të zonës veriore të Italisë (depozitat Sangonini) dhe të Francës (“Marnes a Huitres” nga Baseni i Parisit) sugjerojnë mosha, paleomjedise dhe kushte depozitimi të njëjta në Rupelian (Pashko 1981, 2018). Sipas Pashko (2018) kufiri Rupelian/Chattian përkon me një ndryshim litologjik, thellim të basenit dhe ndryshim i bashkëshoqërimeve të makrofaunës. Kushte paleomjedisore detare të qeta kanë egzistuar në Hatianin i hershëm, gjatë depozimit të Formacionit “Mergelet me Chama” ndërsa në vazhdim gjatë sedimentimit të Formacionit Plasa, janë dokumentuar kuste të ndryshme

detare me ujëra më të cekta dhe me prurje materiale terrigjene të vazhdueshme (Pashko et al. 1973), të cilët reflektohen në litologjinë me ndërthyrje ranorësh kokërr trashë. Me anë të nanofosileve gëlqerore, Kumati et al. (1997) kanë sugjeruar se depozitimet e këtij formacionit janë përfshirë në intervalin Rupelian i vonshëm të Zonës NP24, jo Hatian.

NDËRTIMI GJEOLOGJIK

Zona e studiuar është pjesë e zonës së Moravës (Fig. 1), pjesë përbërëse të Basenit Shqiptaro – Thesalian (Bourcart 1922; Pashko et al. 1973; Pashko 1996, 2018; Xhomo et al. 2002).




Figura 1. Vendodhja e prerjes Rruga e Dardhës 1 (pjesë e planshetës së Dardhës).

Litostratigrafia e depozitimeve të Oligocenit

Depozitimet Oligocenike mbivendosen transgresivisht mbi shkëmbinj të ultramafikë dhe sedimentet me moshë luteciane, në anën lindore dhe jug – lindore të Moravës dhe basenet e tjera në perëndim, veri dhe veri – lindje. Në zonën e Moravës këto sedimente përmbajnë makrofaunë dhe mikrofaunë karakteristike për intervalin Rupelian – Hatianin dhe korrelohen me depozitime sedimentare nga Italia dhe Greqia (Pashko et al. 1973; Pashko 2018). Depozitimet më të vjetra Oligocene i janë caktuar Rupelianit të mesëm - të vonshëm (Bourcart 1922; Nowack 1929; Pashko et al. 1973; Pashko 1977, 1981, 2018; Xhomo et al. 2002) dhe përfshin tre formacione: *Formacioni Mborja – Dishnica* i përbërë nga konglomerate me zaje shkëmbinjsh ultrabazikë dhe gëlqerorë, të ndërthurrur me ranorë masivë dhe pllakorë kokërrtrashë; *Formacioni qymyrbajtës i Drenovës* me mergele, argjila, shtresa qymyri dhe makrofosile karakteristike dhe *Formacioni Drenica* me gëlqerorë me koralë, ranorë, konglomeratë dhe alevrolite. Kati Hatian përfshin dy formacione: *Formacioni “Mergelet me Chama”* (mergele, argjila alevrolitore me makrofosile) dhe *Formacioni ranorik Plasa* (me ndërthurje ranorë pllakorë, alevrolite dhe mergele që përmbajnë gjethe fosile).

Formacioni “Mergelet me Chama”

Në zonën e Moravës, ky formacion dallohet nga prania e depozitimeve mergelore – alevrolitore të cilët mbivendosen transgresivisht mbi sedimentet e moshës Rupeliane

(Bourcart 1922; Pashko et al. 1973; Pashko 1977, 1981, 2018; Xhomo et al. 2002). Ky formacion ka një shtrirje duke filluar nga fshati Plasa në veri deri jug të rrugës Boboshticë – Dardhë. Prerja tipike ka një trashësi prej 86 m dhe është përshkruar nga fusha e Mborjes, përgjatë lumit të Mborjes.

Të dhënat fosile tregojnë praninë e bivalvorëve si *Chama granulosa*, pectinide, skafopode dhe gjithashtu edhe foraminifere bentonike dhe planktonike (Pashko et al. 1973; Pashko 2018). Bashkëshoqërimet makrofosile të Hatianit janë krahasuar me ato të Italisë së veriut, Hungarisë dhe Ultësirës Mezohelenike në Greqi (Pashko et al. 1973; Pashko 1977, 1981, 2018). Prania e foraminiferave si *Lepidocyclina dilatata* dhe *Operculina complanata* si dhe mungesa e species *Nummulites fichtelli*, sugjeron një moshë Oligocene (Hatian i hershëm) për depozitimet e Formacionit “Mergelet me Chama” (Pashko et al. 1973; Pashko 1977, 1981, 2018).

Kumati et al. (1997) ka përcaktuar duke u bazuar në praninë e foraminifereve planktonike, një moshë Rupelian i vonshëmdhe Zona *Globorotalia opima opima* (me *Globigerina ciperoensis angulisuturalis*), ndërsa nanfosilet gëlqerore janë përcaktuar si të Zonës me *Sphenolithus distentus*. Sipas këtij studimit, kufiri Rupelian/Hatian është përcaktuar në pjesën e sipërme të këtij formacionit.

METODOLOGJIA

Përshkrimi i prerjes “Ruga e Dardhës 1” (RD-1)

Prerja “Ruga e Dardhës 1” është pjesë e Formacionit “Mergelet me Chama” dhe gjendet në anën e majtë

të rrugës që shkon për në fshatin e Dardhës (Fig. 1), përballë kompleksit Alpin (40°32'3.93" N, 20°47'28.36" E). Litologjia përfaqësohet nga mergele – alevrolite gri në të kaltër me ndërthurje të ralla dhe të holla ranorë kokërr imët, me përjashtim të disa intervaleve ku këto ranorë arrijnë deri në 10 – 15 cm trashësi. Trashësia e studiuar është rreth 28 – 30 m. Në të gjithë trashësinë e profilit takohen makrofosile si bivalvore, gastropode dhe korale (Fig. 2) dhe *Operculina complanata*. Janë marrë gjithsej 56 prova në intervale prej 0.10 m, 0.20 m, 0.30 m, 0.40 m, 0.50 m deri në 1 m maksimumi (profili është publikuar në Kallanxhi & Young 2020).

Bashkëshoqërimet makrofosile të kësaj prerje janë karakteristike për intervalin e Oligocenit të mesëm dhe mund të krahasohen me ato të Basenit Mezohelenik (Greqi; Harzhauser (2004) dhe të Italisë së Veriut. Bivalvorët dhe gastropodët e

mbledhur përfaqësohen nga specie karakteristike për mjediset më të cekta si *Crassatella*, *Corbula*, *Cordiopsis*, *Venericardia*, specie epibentike si *Chama* dhe *Costellamussiopecten*, dhe një specie bentike *Pholadomya*. Specia më abundente përgjatë prerjes është *Chama tongriana*. Speciet e indentifikuara të bivalvorëve (Fig. 2) në kampionët e mbledhur janë: *Costellamussiopecten* cf. *deletus*, *Crassatella carcarenensis*, *Crassatella neglecta*, *Venericardia* cf. *laurae*, *Cordiopsis incrassatus*, *Trisidos albanica* dhe *Pholadomya puschi*, ndërsa të gastropodeve janë: *Stellaria ornatoparva*, *Ampullinopsis crassatina*, *Turritella* cf. *incisa*, *Turritella* sp., *Haustator asperula*, *Distorsio* sp., *Lithoconus ineditus*, *Amalda* cf. *anomala* etj. Bashkëshoqërimet e foraminiferave (Fig. 2) përfaqësohen nga specie bentike krahas formave të mëdha *Operculina complanata* e cila gjendet në çdo kampion i marrë.



Figura 2. a) Zonë kontakti midis Formacionit Drenica dhe Formacionit Mergelet me Chama, në rrugën Boboshticë – Dardhë. Makrofosile nga pjesa e poshtme të Formacionit “Mergelet me Chama” (x=4482405, y=4489390); **b)** Depozitime mergelore – alevrolitore të Fm. Mergelet me Chama me përmbajtje të lartë makrofosilesh dhe foraminifera (x=4482375, y=4488925; ndodhet përballë restorantit Alpin) (Fotot e nanofosileve: M-E. Kallanxhi; fotot e makrofosileve: O. Mandic; fotot e foraminiferave: A. Dica).

Metodat e përdorur për përgatitjen dhe analizimin i provave

Nanofosilet janë studiuar nga preprate mikroskopike të cilët janë përgatitur sipas metodës standard së përshkruar në Bown & Young (1998) dhe janë analizuar me mikroskopin me dritë të polarizuar me një objektiv me vaj (100x) dhe një zmadhim të fushës prej të paktën 1000x, në fushë të errët e polarizuar (XPL – cross polarised light), në fushë e ndriçuar (BF – bright field), nën lente gipsi (GP – gypsum plate) dhe nën kontrast (PC – phase kontrast).

Për mbledhjen e të dhënave nga kampionët, janë përdorur metoda sasiore dhe gjysëm sasiore të numërimit të nanofosileve nga një bashkëshoqërim prej të paktën 100 deri në 300 individësh/provë (Bown & Young 1998), pastaj përqindjet e specieve janë trajtuar në programin Excel dhe diagramat e ndryshme dhe në programin statistikor PAST (Hammer et al. 2001). Numërim të veçantë dhe matje biometrike janë bërë për specien e rallë *Helicosphaera minima* (Kallanxhi & Young 2020).

Mikrofotografite janë bërë me një kamerë dixhitale (Canon PC1201) të instaluar në mikroskop. Taksonomia e përdorur është sipas Perch-Nielesen (1985), Young (1998) dhe faqjes së internetit Nannotax3 (<http://www.mikrotax.org/Nannotax3>).

Skemat standarde biostratigrafike të nanofosileve gëlqerore për intervalin kohor (Oligocen) i studiuar të cilat u përshtaten edhe rajonit ku ndodhet studimi janë Martini (1971) dhe Okada & Bukry (1980) të cilët bazohen në shfaqjen (FO – first

occurrence) dhe zhdukjen (LO – last occurrence) e specieve treguese, të mbështetura edhe nga disa ngjarje të tjera dytësore. Vlerësimi i cilësisë së nanofosileve ndjek koncepte sipas Roth & Thierstein (1972) dhe në këtë rast është vlerësuar si e moderuar në të mirë.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Bashkëshoqërimet e nanofosileve gëlqerorë

Bashkëshoqërimi i nanofosileve gëlqerorë në profilin Rruga e Dardhës 1 përmban 47 specie autohtone (Fig. 3), 19 specie të ripunuara nga Paleogjeni dhe 12 specie të ripunuara nga Kretaku.

Speciet e nanofosileve gëlqerore autohtone më abundente janë: *Cyclicargolithus floridanus*, *Reticulofenestra minuta*, *Reticulofenestra* gr. 3-5µm, *R. bisecta*, *Coccolithus pelagicus* dhe *Sphenolithus moriformis*. Në sasi më të vogla gjenden speciet: *Zygrhablithus bijugatus bijugatus*, *Reticulofenestra dictyoda*, *Cyclicargolithus abisectus*, *Helicosphaera minima*, *Sphenolithus predistentus*, *Reticulofenestra stavensis*, *Clausicoccus fenestratus*, *C. subdistichus* and *Hughesius tasmaniae*. Specie të tjera të pranishme në sasi shumë të vogla, të renditura sipas alfabetit janë: *Acanthoica* sp., *Braarudosphaera bigelowii*, *Calcidiscus gallagheri*, *Calcidiscus* sp., *Clausicoccus* sp., *Coccolithus miopelagicus*, *Discoaster deflandrei*, *Discoaster* sp., *Ilseilithina fusa*, *Helicosphaera euphratis*, *H. intermedia*, *H. obliqua*, *H. perch-nielseniae*, *H. recta*, *Helicosphaera* sp., *Micrantholithus* sp., *Pontosphaera*

cf. *enormis*, *P. multipora*, *Reticulofenestra daviesii*, *R. lockeri*, *Sphenolithus ciperoensis*, *S. conicus*, *S. distentus*, *S. dissimilis*, *S. tawfikii*, *Sphenolithus* sp., *Triquetrorhabdulus carinatus*, *Umbilicosphaera jafari* and *Zygrhablithus bijugatus maximus*.

Bashkëshoqërimet e nanofosileve gëlqerore përmbajnë në përqindje më të lartë specien *Cyclicargolithus floridanus*, e cila ka një vlerë mesatare prej 39.79 % (me vlerën minimale prej 14.14 % në provën RD-1/58 deri në vlerën maksimale prej 69.23 % në provën RD-1/25). Specie të tjera abundente janë *Reticulofenestra minuta* me një përqindje prej 21.02 % (nga 5.61 % në RD-1/26 deri në 39.06 % në RD-1/06) dhe *Reticulofenestra* gr. 3-5 µm me vetëm 10.59 % (nga 0 % në RD-1/25 deri në 25.45 % në RD-1/52).

Në këtë prerje vihet re një rritje të sasisë së species *Reticulofenestra bisecta* (mesatarja prej 7.52 %, me vlerën maksimale prej 23.58 % në RD-1/27), krahas me profilet e tjera të të njëjtës moshë. Grupi i specieve të *Sphenolithus* spp. gjendet në vlera mesatare prej 5.51 %, me vlera midis 0.86 % (RD-1/19) deri në 14.29 % (RD-1/28), ndër këtyre specia më abundente është *Sphenolithus moriformis* me një vlerë mesatare

prej 3.74 %. Speciet e tjera të cilat gjenden në sasi më të vogla nën 5 % janë: *Coccolithus pelagicus* (një mesatare prej 3.83 %), *Sphenolithus* sp. (3.74 %), *Helicosphaera* spp. (1.61 %) dhe *Reticulofenestra dictyoda* me përmasa 3-5 µm (mesatare prej 1.23 %). Bashkëshoqërimet e ngjashme nanofosile përmenden nga Vathi (1989) dhe Vathi & Budri (1990) nga depozitimet e Zonës Jonike në Shqipëri.

Në këtë profil edhe në prerjet e tjera Oligocenike të zonës së Moravës (Kallanxhi 2020; Basenit Shqiptaro – Thessalian, Shqipëri) të përfshira në Zonën NP24 – *Sphenolithus distentus*, është zbuluar një takson jashtëzakonisht i rrallë, *Helicosphaera minima* (Kallanxhi & Young 2020), duke e bërë këtë shfaqjen e dytë në botë. Kallanxhi & Young (2020) kanë kryer analiza morfometrike në ekzemplarë të përzgjedhur nga kjo prerje dhe dy të tjera të kësaj mosheje dhe, si përfundim kanë përcaktuar madhësinë dhe karakteristikat morfologjike e kësaj specie. Gjithashtu, sipas këtij studimi, diapazoni i njohur kohor i kësaj specie u zgjerua nga NP22 (Rupeliani i hershëm) në NP24 (Rupeliani i vonshëm – Hatian i hershëm).




Figura 3. Nanofosile gëlqerore nga prerja Rruga e Dardhës 1, Formacioni “Mergelet me Chama” XPL – fushë e errët; GP – lente gipsi).

Biostratigrafia e specieve treguese për Oligocenin

Duke u bazuar në praninë dhe bashkëshoqërimin i specieve treguese kryesore (Fig. 4) si: *Sphenolithus ciproensis*, *S. distentus* dhe *S. predistentus*, sëbashku me speciet treguese dytësore (*Pontosphaera cf. enormis* dhe *Triquetrorhabdulus carinatus*), profili i studiuar është përfshirë në zonën biostratigrafike NP24 – *Sphenolithus distentus*

(Martini 1971), nënzona CP19a – *Cyclicargolithus floridanus* (Bukry & Okada 1980), Zona *Sphenolithus distentus* (Vathi 1989), dhe pjesërisht në pjesën e sipërme të zonës CNO4 – *Sphenolithus distentus/S. predistentus* CRZ (Agnini et al. 2014; CRZ – Concurrent Range Zone). Mosha e përcaktuar e zonës NP24 është Oligocen i hershëm – i vonshëm (Rupelian i vonshëm – Hatian i hershëm).




Figura 4. Skema biostratigrafike e specieve treguese të nanofosileve gëlqerore nga prerja Rruqa e Dardhës.

Mbivendosja kohore e intervalit të species *Sphenolithus predistentus*, e cila shfaqet në Lutecian (Zona NP16) dhe zhduket në afërsi të tabanit të zonës NP24, me specie të tjera treguese si *S. distentus* dhe *S. ciperoensis*, e bën këtë një specie shume e rëndësishme për tu marrë në konsideratë për biostratigrafinë e Oligocenit. Në skemën biostratigrafike të Agnini et al. (2014), kjo specie përdoret për idenfifikimin i tabanit të zonës CNO4 – *S. distentus/S. predistentus* CRZ (26.93 Ma), i cili bie në pjesën e sipërme të Zonës NP24, poshtë nivelit të zhdukjes së species *S. distentus*. Taksoni *Sphenolithus predistentus* ka një prani pothuajse pa ndërprerje përgjatë kësaj prerje.

Shfaqja e species *Sphenolithus distentus* në Rupelian, në pjesën e sipërme të zonës NP23 të Martini (1971), është kalibruar në 30.0 Ma nga Agnini et al. (2014) dhe korespondon me bazën e zonës CNO4 – *S. distentus/S. predistentus* CRZ, dhe me bazën e zonës CP18 të Okada & Bukry (1980). Niveli i zhdukjes së këtij treguesit është në Hatian, në kufirin midis zonave NP24/NP25 dhe nënzonave CP19a/CP19b (Bukry 1973, 1975). Ky nivel përkon edhe me bazën e nënzonës MNP25a – *Sphenolithus ciperoensis* PRZ të Fornaciari & Rio (1996).

Një tjetër specie treguese për Oligocenin është *Sphenolithus ciperoensis*, shfaqja e së cilës përdoret për të idenfikuar bazën e zonës NP24 të Martini (1971), ndërsa zhdukja e saj tregon tabani i Zonës NP25. Sipas Martini (1971), zona NP25 korespondon me Hatianin i mesëm – i vonshëm dhe korelohet me zonën CP19b të Okada & Bukry (1980). Kjo

specie shfaqet edhe në profilin Rruga e Dardhës 1, por është i rrallë dhe në sasi shumë të vogla. Agnini et al. (2014) kalibron zhdukjen e këtij taksoni në 24.36 Ma, në kufirin midis zonave CNO5/CNO6 në Hatian. Zhdukja e *S. ciperoensis* është një interval i besueshëm në zonën Mesdhetare (Fornaciari & Rio 1996) dhe në rajonet që gjenden në latituda të ulta dhe të mesme (Perch-Nielsen 1985; Wei & Wise 1989).

Specie të tjera treguese të cilat kontribuojnë në biostratigrafinë e Oligocenit janë *Triquetrorhabdulus carinatus*, i cili shfaqet në pjesën e poshtme të zonave of NP25/CN19b në Hatian dhe *Helicosphaera obliqua* (FO në zonën NP24; Young 1998). Këto specie janë të pranishme në këtë studim, por jo me frekuencë të madhe. Specia *Pontosphaera* cf. *enormis* është shumë e rrallë në kampionët e analizuar, por duke marrë parasysh se kjo specie shfaqet në afërsi të kufirit midis biozonave NP24/NP25 (Martini 1981), konsiderohet një ngjarje e rëndësishme në rajone të cilët nuk kanë lidhje të vazhdueshme me detitn i hapur.

PËRFUNDIME

Nanofosilet gëlqerore janë studiuar nga prerja Rruga e Dardhës 1, pjesë e Formacioni “Mergele me Chama” në zonën e sedimentimit të Moravës (Baseni Shqiptaro – Thessalian, Korçë). Në përfundim të këtij studimit janë përcaktuar:

- Bashkëshoqërimet e nanofosileve gëlqerore, të cilët përmbajnë 47 specie autohtone, 19 specie të ripunuara nga Paleogjeni dhe 12 specie të ripunuara nga Kretaku.

- Janë identifikuar speciet treguese kryesore për intervalin moshor i studiuar të cilët janë: *Sphenolithus predistentus*, *Sphenolithus distentus*, *Sphenolithus ciperoensis*, *Pontosphaera cf. enormis* dhe *Triquetrorhabdulus carinatus*.
 - Zonat standarde NP24 - *Sphenolithus distentus* dhe CP19a - *Cyclicargolithus floridanus* të cilët sugjerojnë një moshë të përgjithsme Rupelian i vonshëm – Hatian i hershëm.
 - Ky studim lejon hapësirë në të ardhmen për studime të mëtejshme dhe korrelime me grupe të tjera fosile.
- Falënderime.** Ky studim është pjesë e tezës së doktoraturës së autores dhe u mundësua nëpërmjet grantit “Sectorial Operational Program for Human Resources Development 2007–2013, i mbështetur nga “European Social Fund” projekti POSDRU/159/1.5/S/132400, me titull “Young successful researchers – professional development in an international and interdisciplinary environment”, dhe bursës “Erasmus+ traineeship mobility” në periudhën Mars–Qershor 2016, në Montanuniversität Leoben, Austri. Një falënderim të veçantë është për Drs. Oleg Mandic and Mathias Harzhauser nga Muzeumi i Shkecanve të Natyrës Vjenë (Austria) për mbështetjen e tyre në përpunimi, analizimi dhe fotografimi i makrofosileve (bivalvoret dhe gastropodet), për Patrick Bukenberger (Department of Palaeontology, University of Vienna) përgatitjen e foraminiferave dhe për Alexandru Gabriel Dica i cili ka mbështetur me analizimin dhe fotografite e foraminiferave.

REFERENCAT

- AGNINI C., FORNACIARI E., RAFFI I., CATANZARITI R., PÄLIKE H., BACKMAN J. & RIO D. (2014).** BIOZONATION AND BIOCHRONOLOGY OF PALEOGENE CALCAREOUS NANNOFOSSILS FROM LOW AND MIDDLE LATITUDES. *NEWSLETTERS ON STRATIGRAPHY*, 47(2), 131-181. [HTTP://DX.DOI.ORG/10.1127/0078-0421/2014/0042](http://dx.doi.org/10.1127/0078-0421/2014/0042)
- BOURCART J. (1922).** LES CONFINES ALBANAIS ADMINISTRES PAR LA FRANCE (1916-1920). CONTRIBUTION À LA GÉOGRAPHIE ET À LA GÉOLOGIE DE L'ALBANIE MOYENNE. *LIBRAIRIE DELAGRAVE*, PARIS, P. 265.
- BOWN P.R. & YOUNG J.R. (1998).** CALCAREOUS NANNOFOSSIL BIOSTRATIGRAPHY (BRITISH MICROPALAEONTOLOGICAL SOCIETY PUBLICATIONS SERIES; BOWN P.R., ED.), *CHAPMAN AND KLUWER ACADEMIC*, LONDON, P. 288
- FORNACIARI E. & RIO D. (1996).** LATEST OLIGOCENE TO EARLY MIDDLE MIOCENE QUANTITATIVE CALCAREOUS NANNOFOSSIL BIOSTRATIGRAPHY IN THE MEDITERRANEAN REGION. *MICROPALAEONTOLOGY*, 42(1), 1-36. [HTTP://DX.DOI.ORG/10.2307/1485981](http://dx.doi.org/10.2307/1485981)
- FORNACIARI E., DI STEFANO A., RIO D. & NEGRI A. (1996).** MIDDLE MIOCENE CALCAREOUS NANNOFOSSIL BIOSTRATIGRAPHY IN THE MEDITERRANEAN REGION. *MICROPALAEONTOLOGY*, 42(1), 37-63.
- HAMMER Ø., HARPER D.A.T. & RYAN P.D. (2001).** PAST: PALEONTOLOGICAL STATISTICS SOFTWARE PACKAGE FOR EDUCATION AND DATA ANALYSIS. *PALAEONTOLOGIA ELECTRONICA*, 4 (1): 1-9.
- HARZHAUSER M. (2004).** OLIGOCENE GASTROPOD FAUNAS OF THE EASTERN MEDITERRANEAN (MESOHELLENIC TROUGH / GREECE AND ESFAHAN-SIRJAN BASIN/ CENTRAL IRAN). *COUR. FORSCH.- INST. SENCKENBERG*, 248: 93-181.

- KALLANXHI M.-E., ČORIĆ S. & KOÇIU A. (2016).** LATE OLIGOCENE CALCAREOUS NANNOFOSSILS FROM ALBANIAN-THESSALIAN INTRAMONTANE BASIN (BOZDOVEC SECTION, ALBANIA) - A QUANTITATIVE APPROACH, *STUDIA UBB GEOLOGIA*, 60(1), 5-20. DOI: [HTTP://DX.DOI.ORG/10.5038/1937-8602.60.1.1286](http://dx.doi.org/10.5038/1937-8602.60.1.1286)
- KALLANXHI M.-E. (2020).** CALCAREOUS NANNOFOSSILS FROM OLIGOCENE TO MIDDLE MIOCENE DEPOSITS OF THE ALBANIAN-THESSALIAN BASIN (ALBANIA). PHD THESIS, p. 272.
- KALLANXHI M.-E. & YOUNG J.R. (2020).** REDISCOVERY OF THE *HELICOSPHAERA MINIMA* IN THE OLIGOCENE DEPOSITS OF THE ALBANIAN-THESSALIAN BASIN (ALBANIA). *JOURNAL OF NANNOPLANKTON RESEARCH*, 38(1), 17-26.
- KALLANXHI M.-E. (2023).** BIOSTRATIGRAPHY OF CALCAREOUS NANNOFOSSILS AND PALAEOENVIRONMENTS IN THE LOWER MIOCENE OF THE ALBANIAN-THESSALIAN BASIN (ALBANIA). *GEOLOGICA CARPATHICA*, 74(1), 41-58.
- KALLANXHI M.-E. (2024).** RAPORT SHKENCOR (STUDIMI), I PROJEKTIT ME TITULL:“SAKTËSIMË DHE PLOTËSIMË TË HARTAVE SHUMËQËLLIMORE TË SHQIPËRISË (KOMPONENTI GJELOGJI), SIPAS PLANSHETAVE NË SHKALLË 1:25 000”, PLANSHETA K-34-126-B-C (DARDHA). A.Q.T.GJ., SHËRBIMI GJEOLGJIK SHQIPTAR.
- KUMATI LL., KORROVESH I., MYFTARI S., VATHI K., MARKU D., SADUSHI P., GJANI E., DULAJ A., SHTREPI P., SEITI E., VEIZAJ V., ZAKA M. & POLO S. (1997).** STUDY ON THE STRUCTURE, BIOSTRATIGRAPHY, DEPOSITIONAL ENVIRONMENT AND GEOCHEMICAL POTENTIAL OF SHQIPTARO-THESSALIAN- MESOHELLENIC BASIN, IN BURREL-KORÇA-GREECE REGION). *INSTITUTI I STUDIMEVE DHE I PROJEKTIMEVE GJEOLGJIKE TE NAFTËS DHE GAZIT*, FIER.
- MARTINI E. (1971).** STANDARD TERTIARY AND QUATERNARY CALCAREOUS NANNOPLANKTON ZONATIONS. IN: PROCEEDINGS 2ND INTERNATIONAL CONFERENCE ON PLANKTONIC MICROFOSSILS ROMA 1970 (FARINACCI, A., ED.). *EDIZIONI TECNOSCENZA*, ROMA, 2, 739-785.
